



## RAPORT

# ZHVILLIMI PROFESIONAL DHE VLERËSIMI I MËSUESVE NË SHQIPËRI



Janar 2015

## © Koalicioni për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri, Tiranë 2015.

Riprodhimi i pjesshëm i këtij raporti mund të bëhet vetëm me lejen me shkrim të Koalicionit për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri. Ndalohet shitja ose riprodhimi i plotë i tij.



Financuar nga:



Ky dokument është përgatitur për Koalicionin për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri (ACCE); Raporti reflekton pikëpamjet dhe mendimet e autorëve të tij dhe jo domosdoshmërisht ato të organizatës. ACCE nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për mënyrën sesi ky informacion mund të përdoret nga të tjerët.

Për më shumë informacion për punën e Koalicionit të Arsimit në Shqipëri mund të lexoni në faqen tonë të internetit <http://www.acce.crca.al/>

**Referenca për këtë raport është:** Haxhiymeri E., Mita N., Zhvillimi Profesional dhe Vlerësimi i Mësuesve në Shqipëri, Koalicioni për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri, Tiranë 2014.

ISBN

Foto në kopertinë: © CRCA Albania

Botuar në Tiranë në 200 kopje





# **RAPORT ZHVILLIMI PROFESIONAL DHE VLERËSIMI I MËSUESVE NË SHQIPËRI**

**Përgatitur nga:**

**Prof. Dr. Edlira Haxhiymeri**

**Prof. Dr. Nikoleta Mita**

**Redaktuar nga:**

**Altin Hazizaj**

# PËRMBAJTJA

## 1. Përmbledhje ekzekutive

## 2. Vështrim i përgjithshëm mbi sistemin e vlerësimit të mësuesve në Shqipëri

## 3. Metodologjia e vlerësimit

3.1 Qëllimi i vlerësimit

3.2 Metodologjia e vlerësimit

3.3 Burimi i të dhënave

## 4. Korniza ligjore, institucionale dhe e politikave

4.1 Baza ligjore për statusin e mësuesit

4.2 Akte nënligjore

4.3 Baza institucionale

4.4 Politika për zhvillimin e profesionit të mësuesit

## 5. Tablo e situatës aktuale

5.1 Të dhëna për mësuesit

5.2 Praktika për zhvillimin profesional dhe vlerësimin e mësuesve

5.2.1 Praktika që lidhen me të drejtën e ushtrimit të profesionit

5.2.2 Praktika që lidhen me kualifikimin e mësuesve

5.2.3 Praktika që lidhen me zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve

5.3. Problematika për zhvillimin profesional dhe vlerësimin e mësuesve

## 6. Praktikrat dhe modelet më të mira për zhvillimin profesional dhe vlerësimin e mësuesve

## 7. Gjetje dhe rekomandime

7.1 Gjetje

7.2 Rekomandime

7.2.1 Rekomandime për përmirësimin e legjislacionit

7.2.2 Rekomandime për bazën institucionale

7.2.3 Rekomandime për politikën strategjike

7.2.4 Rekomandime për sistemin e përgatitjes së mësuesve

7.2.5 Rekomandime për sistemin e vlerësimit për fitimin e të drejtës së ushtrimit të profesionit të mësuesit

7.2.6 Rekomandime për sistemin e vlerësimit të zhvillimit profesional

7.2.7 Rekomandime për sistemin e vlerësimit të performancës.

## 8. Referenca

## SHKURTESA

AKP	Agjencia Kombëtare e Provimeve
APAAL	Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë
ACCE	Koalicioni për Arsimin e Fëmijëve në Shqipëri
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale
IAL	Institucioni i Arsimit të Lartë
ISHA	Inspektorati Shtetëror i Arsimit
IZHA	Instituti i Zhvillimit Arsimor
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MASH	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
ZA	Zyra Arsimore

## LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKEVE

### LISTA E TABELAVE

- Tab.1 Numri i edukatoreve të arsimit parashkollor
- Tab.2 Numri i edukatoreve sipas DAR/ZA
- Tab.3 Numri i mësuesve në arsimin bazë
- Tab.4 Numri i mësuesve në arsimin bazë sipas gjinisë, vendndodhjes së shkollës për vitin shkollor 2011-2012 sipas DAR/ZA për vitin shkollor 2011-2012
- Tab.5 Numri i mësuesve në arsimin bazë në vite sipas gjinisë dhe vendndodhjes së shkollës
- Tab.6 Numri i mësuesve në arsimin e mesëm sipas gjinisë, vendndodhjes së shkollës për vitin shkollor 2011-2012 i edukatoreve sipas DAR/ZA për vitin shkollor 2011-2012
- Tab.7 Numri i mësuesve në arsimin parauniversitar dhe niveli i arsimimit
- Tab. 8 Numri i mësuesve në arsimin parauniversitar dhe niveli i arsimimit
- Tab.9 Të dhëna për kualifikimin e mësuesve

### LISTA E GRAFIKEVE

- Fig.1 Skema institucionale për formimin, zhvillimin profesional dhe kualifikimin e mësuesve
- Fig. 2 Numri i edukatoreve të arsimit parashkollor
- Fig.3 Numri i mësuesve në arsimin bazë
- Fig.4 Numri i mësuesve në arsimin bazë publik dhe privat
- Fig.5 Numri i mësuesve në arsimin bazë sipas gjinisë
- Fig.6 Mësues gjithsej në arsimin parauniversitar
- Fig. 7 Mësues në arsimin parauniversitar publik
- Fig.8 Mësues në arsimin parauniversitar privat
- Fig.9 Numri i edukatoreve të kopshtit në arsimin publik sipas nivelit të arsimimit
- Fig.10 Numri i edukatoreve të kopshtit në arsimin publik sipas nivelit të arsimimit
- Fig.11 Numri i mësuesve të arsimit bazë në arsimin publik sipas nivelit të arsimimit
- Fig.12 Numri i mësuesve të arsimit bazë në arsimin privat sipas nivelit të arsimimit
- Fig.13 Numri i mësuesve të arsimit të mesëm në arsimin publik sipas nivelit të arsimimit
- Fig.14 Numri i mësuesve të arsimit të mesëm në arsimin privat sipas nivelit të arsimimit

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Në 22 vitet e fundit në kuadrin e reformës arsimore është ndërmarë edhe reformimi i profesionit të mësuesit. Dy shtyllat kryesore të reformës për profesionin e mësuesit kanë qenë: hartimi i një kornize ligjore të plotë dhe zbatimi i një politike të re. Arritje pozitive janë shënuar lidhur me dokumentacionin ligjor për statusin e mësuesit, ndërsa është punuar më pak për strategjinë e zhvillimit të profesionit.

Konteksti aktual i përbërë nga arritjet ende të ulta të nxënësve sipas rezultateve të studimit ndërkombëtar Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA), rezultatet e maturës shtetërore, rezultatet e vlerësimit të mësuesve dhe nisma për reformim të mëtejshëm të sistemit të përgatitjes dhe vlerësimit të mësuesve janë bërë shtypa për këtë vlerësim.

Vlerësimi ka si objekt zhvillimin profesional dhe vlerësimin e mësuesve në Shqipëri. Ai synon që:

- të paraqesë një vështrim të legjislacionit përkatës arsimor;
- të identifikojë aspektet ligjore që duhen përmirësuar në lidhje me çështjen e marrë në vlerësim;
- të identifikojë dhe të vlerësojë politikatat që nuk funksionojnë;
- të paraqesë një tablo të situatës aktuale të zhvillimit profesional dhe vlerësimit të mësuesve;
- të paraqesë praktikatat dhe modelet më të mira për zhvillimin profesional dhe vlerësimin e mësuesve.
- të paraqesë rekomandime afatshkurtra dhe afatgjata për përmirësime.

Raporti përqendrohet në tre aspekte kryesore: në të drejtën e ushtrimit të profesionit; në sistemin e kualifikimit të mësuesve; në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve.

Për hartimin e këtij raporti u përdorën disa qasje të vlerësimit të programit dhe më konkretisht:

- a) qasja e bazuar në ekspertizë, e cila u bazua në ekspertizën profesionale për të gjykuar dobinë dhe efektshmërinë e reformave të deritanishme për profesionin;
- b) qasja e bazuar në objektiva, e cila synon të vlerësojë nivelin e arritjes të objektivave strategjike të reformës për mësuesinë;
- c) qasja e bazuar në vendime, e cila synon të përcaktojë sesi mund të zgjidhen problemet që lidhen me zhvillimin profesional dhe vlerësimin e mësuesve.

Metodologjia e përdorur për hartimin e këtij raporti përfshiu:

- Aanalizën e dokumenteve zyrtare: aktet ligjorë dhe nënligjore të politikës arsimore si dhe raporte të ndryshëm.
- Intervista dhe fokus grupe me mësues, drejtues dhe specialistë të arsimit nga rrethe të ndryshme të vendit. U intervistuan 10 drejtues të shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm, dhe u kryen dy fokus grupe me 15 mësues dhe 5 specialistë të arsimit.
- Analizën e të dhënave statistikore të MAS për mësuesit dhe të IZHA për kualifikimin e mësuesve.

- Analizën e modeleve të zhvillimit profesional dhe të vlerësimit të mësuesve në botë me qëllin identifikimin e modeleve më të suksesshme që mund të përdoren ose të përshtaten në Shqipëri.

Nga vlerësimi i kryer prezantohen këto gjetje kryesore:

- Krijimi i një legjislacioni mbështetës për profesionin e mësuesit ka ndihmuar zhvillimin e profesionit të mësuesit. Në dekadën e fundit (2004-2014), Kuvendi i Shqipërisë dhe Qeveria kanë miratuar një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore, që kanë ndikuar në zhvillimin e arsimit në tërësi dhe në profesionin e mësuesit gjithashtu, duke mbështetur ndryshimet në sistemin arsimor dhe përmirësimin e mundësive për nxënësit dhe statusin e mësuesit.
- Përfshirja e profesionit të mësuesit në profesionet e rregulluara është një hap pozitiv që pritet të garantojë një cilësi më të mirë të mësuesve.
- Skema e trajnimeve për mësuesit është tashmë e ndryshuar, duke përcaktuar programet, kriteret, kreditet e kërkuara dhe duke e liberalizuar tregun e trajnimeve.
- Rritja e numrit të mësuesve me arsim të lartë është një prirje pozitive për një cilësi më të lartë të mësuesve.
- Mungojnë kërkimet, vlerësimet apo të dhënat e plota që të mundësojnë një informacion tërësor për ndikimin e legjislacionit dhe të politikave në arsim dhe në statusin e mësuesve.
- Mungon një politikë vizionare tërësore për zhvillimin e profesionit të mësuesit dhe sistemeve të vlerësimit të mësuesve në Shqipëri u mungon bazamenti teorik. Gjithashtu mungojnë studimet, vlerësimet kombëtare mbi bazën e të cilave do të mund të hartoheshin politikat dhe do të merreshin vendime më të mira për mësuesit.
- Shteti është ende shumë i përfshirë në sistemin e vlerësimit të mësuesve. Sistemi më problematik është ai i vlerësimit të performancës së mësuesit që është përgjegjësi e shkollës.
- Politikat e ndërmarra deri më sot nga Ministria e Arsimit, kanë reformuar sistemin e përgatitjes së mësuesve duke ndryshuar strukturën kurrikulare, por nuk u arrit përafrimi i kurrikulave të Institucioneve të Arsimit të Lartë, për shkak të qasjeve të ndryshme që ato kanë përzgjedhur.
- Numri i mësuesve në arsimin parashkollor dhe arsimin e mesëm është rritur, ndërsa numri i mësuesve në arsimin bazë ka pësuar rënie.
- Vërehet se ka mungesë të balancës gjinore në personelin e punësuar në sistemin arsimor. Shumica e mësuesve në arsimin bazë dhe të mesëm janë femra dhe se asnjë mashkull nuk është i punësuar në arsimin parashkollor.



- Cilësia në hyrje e studentëve që përgatiten për mësues ka rreth 20 vjet që është shumë e ulët, teksa nota mesatare e studentëve në hyrje është nga 5-7, krahasuar me degët e tjera ku kërkohet një mesatare më e lartë për të hyrë në shkollën e lartë.
- Marrëdhënia ndërmjet universiteteve dhe shkollave gjatë periudhës së praktikës profesionale nuk është e rregulluar nëpërmjet ndonjë dokumenti rregullator dhe supervizimi i kryerjes së praktikës dhe vlerësimit të saj shoqërohet me problematika të shumta. Sistemi i mentorimit për praktikën profesionale është i zbehtë dhe pothuajse nuk funksionon.
- Publikimi i të dhënave dhe rezultateve të vlerësimit të mësuesve është pothuajse inekzistent.

Mbështetur në përvojat më të mira, për përmirësimin e sistemit të zhvillimit profesional dhe vlerësimit të mësuesit në Shqipëri, së pari, duhet adoptuar një filozofi, e cila të mbështesë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimin; të motivojë personelin mësimor në hartimin e programeve individuale për vetëpërmirësim; të lidhë zhvillimin personal me objektivat e zhvillimit të shkollës, të vlerësojë arritjet e mësuesit dhe të përcaktojë objektiva konstruktivë, të krijojë një mjedis pozitiv pune.

Së dyti, duhet hartuar një kornizë filozofike, e cila duhet mbështetur në objektivat e përgjithshme të zhvillimit të shkollës; të përmbajë të shprehura qartë objektivat e zhvillimit profesional dhe të vlerësimit të mësuesit; të përfshijë si vlerësimin formues për përmirësim edhe atë përmbledhës për përcaktimin e meritave; të përcaktojë qartë përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në procesin e reformës.

Së treti, duke qenë se sistemi i deritanishëm bazohet në profesionin e rregulluar, duhet ndjekur përvoja e vendeve që e kanë të rregulluar këtë profesion dhe që praktikojnë “Urdhërin e Mësuesit” si njësi zbatuese.

## 2. Vështrim i përgjithshëm mbi sistemin e vlerësimit të mësuesve në Shqipëri

Pas viteve 90-të Shqipëria është përfshirë në reformimin e arsimit duke synuar ta rimodelojë sistemin arsimor në mënyrë që t'i përgjigjet standardeve evropiane dhe zhvillimeve globale në arsim. Vizioni i arsimit në Shqipëri është të ndërtohet dhe garantohet një sistem arsimor kombëtar modern që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rrit konkurrencën në rajon dhe konsolidon demokracinë.

Reforma arsimore është përqendruar në katër fusha kryesore : ligjore dhe administrative, kurrikulare, të teknologjisë mësimore dhe burimeve njerëzore.

Reforma legjislativë dhe administrative ka si synim hartimin e një kuadri ligjor bashkëkohor të përafuar me atë evropian, ndërtimin e një shkollë demokratike, mbështetjen e procesit të decentralizimit dhe rritjen e iniciativës lokale, fuqizimin e lidhjeve me komunitetin, rritjen e nivelit të pjesëmarrjes së mësuesve, nxënësve dhe prindërve në procesin e vendimmarrjes.

Reforma kurrikulare ka në qendër dy qasje kryesore : kurrikula me në qendër nxënësin dhe kurrikula e bazuar në kompetenca.

Reforma për teknologjinë mësimore synon të modernizojë mësimdhënien dhe të nxënit nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për qëllime mësimore.

Reforma e burimeve njerëzore synon përmirësimin e cilësisë së punonjësve të sektorit të arsimit dhe në veçanti të mësuesve për të zbatuar reformën kurrikulare dhe për të realizuar procesin e demokratizimit të arsimit.

Mësuesit luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së arsimit. Duke mbajtur parasysh këtë konsideratë, historikisht në Shqipëri qeveritë kanë treguar angazhim për përgatitjen dhe kualifikimin e mësuesve.

Në periudhën para viteve 90-të përgatitja e mësuesve të arsimit bazë bëhej pranë Instituteve të larta pedagogjike, përgatitja e mësuesve për shkollat e mesme bëhej pranë Universitetit të Tiranës, ndërsa përgatitja e edukatoreve të kopshteve bëhej pranë shkollave të mesme pedagogjike. Kualifikimi i mësuesve pas studimeve kryhej pa shkëputje nga puna në mënyrë të organizuar nga Ministria e Arsimit periodikisht çdo pesë vjet në aspektin ideopedagogjik dhe shkencor. Kabinetet pedagogjike në bazë rrethi, rrethet metodike dhe komisionet e lëndëve në bazë shkolle mbështesnin kualifikimin e mësuesve. Puna e mësuesve vlerësohej me distinktivin «Mësues i Dalluar» dhe titujt «Mësues i Popullit» dhe «Mësues i Merituar» që jepeshin duke nisur nga viti 1950 respektivisht nga Ministria e Arsimit dhe Presidiumi i Kuvendit Popullor.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Shefik Osmani. Fjalori i Pedagogjisë, Tiranë, 1983, fq.434-436.

Që në vitin 1992 dhe në vijim, qeveria shqiptare ka ndërmarrë reforma për profesionin e mësuesit. Dy shtyllat kryesore të reformës për profesionin e mësuesit kanë qenë: hartimi i një kornize ligjore të plotë dhe zbatimi i një politike të re. Arritje pozitive janë shënuar lidhur me dokumentacionin ligjor për statusin e mësuesit, ndërsa është punuar më pak për strategjinë e zhvillimit të profesionit.

Aktualisht mësuesit e të gjitha niveleve përgatiten në institucionet e arsimit të lartë në programet Bachelor dhe Master dhe hyrja në profesion bëhet pas fitimit të të drejtës së ushtrimit të profesionit të mësuesit sipas «Ligjit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë».

Politika e profesionit të mësuesit përfshin përgatitjen e mësuesve, zhvillimin e vazhdueshëm profesional si dhe kualifikimin e mësuesve. Zhvillimin profesional të mësuesve e planifikon institucioni arsimor, sipas nevojave të mësuesve dhe në përputhje me politikat arsimore qendrore, vendore dhe të institucionit.

Kualifikimi i mësuesve parashikon tri kategori: kategoria e parë: «Mësues mjeshtër»; kategoria e dytë: «Mësues i kualifikuar»; kategoria e tretë: «Mësues specialist». Rritja në kategori e mësuesit bëhet bazuar në përvojën, trajnimin dhe pasi të ketë dhënë me sukses provimin përfundimtar të kategorisë përkatëse të kualifikimit. Kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve përcaktohen me udhëzim të ministrit të arsimit. Çdo kategori kualifikimi shoqërohet me një shtesë në pagë, masa e së cilës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.<sup>2</sup>

Megjithë përpjekjet reformuese dhe përmirësimet e realizuara në këto 22 vitet e fundit, arsimit në Shqipëri vijon të ndeshet me shumë probleme që lidhen me: zbatimin e legjislacionit; mungesën e mekanizmave mbështetës për zbatimin e nismave të ndërmarra; vendimmarrjen e pabazuar në evidenca, vlerësime dhe kërkime; cilësinë e pakënaqshme të burimeve njerëzore, me infrastrukturën e varfër dhe me mbështetjen e pakët financiare.

Mungojnë kërkimet, vlerësimet apo të dhënat e plota që të mundësojnë një informacion tërësor për ndikimin e legjislacionit dhe të politikave në arsim dhe në statusin e mësuesve. Megjithatë ka informacione nga burime të ndryshme si Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), Insituti i Statistikës (INSTAT), Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), Agjencia Publike e Arsimit të Lartë (APAAL), Inspektorati Shtetëror i Arsimit (ISHA), Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), të cilat dëshmojnë për progres në aspekte të tilla si: zhvillimi i sistemit publik dhe privat i arsimit, zhvillimi i kurrikulës, zbatimi i procesit të Bolonjës, rregullimi i profesionit të mësuesit.

---

<sup>2</sup> Ligj Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, neni 57,58, 59.

## 3. Metodologjia e vlerësimit

### 3.1 Qëllimi i vlerësimit

Vlerësimi i ndërmarrë ka si objekt zhvillimin profesional dhe vlerësimin e mësuesve në Shqipëri.

Vlerësimi synoi:

- të paraqesë një vështrim të legjislacionit përkatës arsimor;
- të identifikojë aspektet ligjore që duhen përmirësuar lidhur me çështjen e marrë në vlerësim;
- të identifikojë dhe të vlerësojë politikat që nuk funksionojnë;
- të paraqesë një tablo të situatës aktuale të zhvillimit profesional dhe vlerësimit të mësuesve;
- të paraqesë praktikatat dhe modelet më të mira për zhvillimin profesional dhe vlerësimin e mësuesve.
- të paraqesë rekomandime afatshkurtra dhe afatgjata për përmirësime.

Vlerësimi i mësuesve do të përqendrohet në tre aspekte kryesore: në të drejtën e ushtrimit të profesionit; në sistemin e kualifikimit të mësuesve; në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve.

### 3.2 Metodologjia e vlerësimit

Për hartimin e këtij raporti u përdorën disa qasje të vlerësimit të programit dhe më konkretisht:

- a) qasja e bazuar në ekspertizë, e cila u bazua në ekspertizën profesionale për të gjykuar dobinë dhe efektshmërinë e reformave të deritanishme për profesionin e mësuesit;
- b) qasja e bazuar në objektiva, e cila synoi të vlerësojë nivelin e arritjes të objektivave strategjike të reformës për mësuesin;
- c) qasja e bazuar në vendime, e cila synoi të përcaktojë sesi mund të zgjidhen problemet që lidhen me zhvillimin profesional dhe vlerësimin e mësuesve.

Metodologjia e përdorur për hartimin e këtij raporti përfshiu:

- a) Aanalizën e dokumenteve zyrtare: akte ligjore dhe nënligjore, të politikës arsimore dhe raporte. Kjo analizë pati si synim e vlerësimin e rëndësisë, të dobisë, të ndikimit të këtyre dokumenteve dhe të problemeve në zbatimin e tyre.
- b) Intervista dhe fokus grupe me mësues, drejtues dhe specialist të arsimit nga rrethe të ndryshme të vendit. U intervistuan 10 drejtues të shkollave të arsimit bazë dhe të

mesëm, u kryen dy fokus grupe me 15 mësues dhe 5 specialistë të arsimit. Analiza e informacionit të mbledhur nga intervistat dhe fokus grupet është pasqyruar në seksionin e problemeve dhe atë të rekomandimeve.

- c) Analizën e të dhënave statistikore të MAS për mësuesit dhe të IZHA për kualifikimin e mësuesve. Këto analiza u kryen me qëllim që të kuptohet tabloja e zhvillimit të profesionit të mësuesit në Shqipëri dhe të paraqiten rekomandime për të ardhmen.
- d) Analizën e modeleve të zhvillimit profesional dhe të vlerësimit të mësuesve në botë me qëllim identifikimin e modeleve më të suksesshme që mund të përdoren ose të përshtaten në Shqipëri.

### **3.3 Burimi i të dhënave**

Si burim informacioni për këtë vlerësim kanë shërbyer: dokumentacioni ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar për mësuesit, si:

- a) Dokumentacioni zyrtar kombëtar: dokumentacioni ligjor kombëtar; akte nënligjore të Këshillit të Ministrave, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, dokumente të Institutit të Zhvillimit Arsimor, të Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, të Agjencisë Kombëtare të Provimeve, të Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, të Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore.
- b) Dokumente ndërkombëtare për mësuesit, si dokumente të UNESCO-s; OECD, Bashkimit Evropian.
- c) Intervista me 10 drejtues të shkollave të arsimit bazë dhe të mesëm dhe dy fokus grupe: njëri me 15 mësues dhe tjetri me 5 specialistë të arsimit.



## 4. Korniza ligjore, institucionale dhe e politikave për statusin dhe vlerësimin e mësuesve në Shqipëri

Përgatitja, zhvillimi profesional dhe kualifikimi i mësuesve realizohen mbi një bazë ligjore që përbëhet nga ligje, të cilat miratohen nga Kuvendi i Shqipërisë dhe akte nënligjore (vendime, urdhëra, udhëzime, rregullore), të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Arsimit dhe Sportit.

### 4.1. Baza ligjore për statusin e mësuesit në Shqipëri

Në dekadën e fundit (2004-2014), Kuvendi i Shqipërisë dhe Qeveria kanë miratuar një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore, që kanë ndikuar në zhvillimin e arsimit në tërësi dhe në profesionin e mësuesit gjithashtu, duke mbështetur ndryshimet në sistemin arsimor dhe përmirësimin e mundësive për nxënësit dhe statusin e mësuesit.

Aktualisht, një tërësi dokumentesh ligjore rregullojnë profesionin e mësuesit:

- **Ligji Nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin Nr. 10357, datë 16.12.2010** është dokumenti kryesor për profesionet e rregulluara, përfshirë edhe profesionin e mësuesit. Qëllimi i këtij ligji është: a) përcaktimi i kriterëve për ushtrimin e disa profesioneve të rëndësishme, të cilat lidhen me mbrojtjen e interesit publik, të sigurisë publike dhe të shëndetit, duke respektuar parimin e shqyrtimit të pavarur dhe autonomisë e profesionistëve; b) mbrojtja dhe garantimi i standardeve për disa profesione të rëndësishme, në mënyrë që ushtrimi i tyre të bëhet prej personave të kualifikuar, të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ky ligj apo ligje të tjera. Ky ligj përmban kushtet dhe kriteret për ushtrimin e një profesioni të rregulluar; kualifikimet e kërkuara për një profesion të rregulluar; procedurat për të fituar të drejtën për ushtrimin e profesionit; përgjegjësitë e profesionistit dhe të autoriteteve përgjegjëse për ushtrimin e profesionit.
- **Ligji Nr. 69, datë 21.6.2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.** Qëllimi i këtij ligji është: a) të përcaktojë parimet bazë lidhur me strukturën, veprimtarinë, dhe drejtimin e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë; b) të garantojë të drejtën kushtetuese për arsim, në përputhje me kornizën përkatëse ligjore. Ky ligj rregullon këto aspekte që lidhen me profesionin e mësuesit, si: statusi i mësuesit, formimi, kualifikimi dhe zhvillimi profesional, të drejtat e mësuesit, pranimi dhe largimi nga puna.
- **Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 (i ndryshuar) “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.** Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë misionin, objektivat kryesorë të arsimit të lartë dhe të rregullojë aspekte të krijimit, organizimit, drejtimit, administrimit, financimit, sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet evropiane dhe përcakton rolin e shtetit dhe të shoqërisë për arsimin e lartë.

Nga këndvështrimi i profesionit të mësuesit, ky ligj rregullon çështjet që lidhen me programet e studimeve universitare dhe sigurimin e cilësisë.

- **Ligji Nr. 7961 of 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”**, i ndryshuar me Ligjin Nr. 8085 of 13.03.1996, ndryshuar me Ligjin Nr. 9125, datë 29.07.2003 është dokumenti kryesor që rregullon çështje të punësimit në Shqipëri. Ky ligj zbatohet edhe për profesionin e mësuesit.
- **Ligji Nr.10247, datë 04.03.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”**. Ky ligj ka objekt përcaktimin e strukturës, të objektivave, të funksioneve dhe të fushave, ku e shtrin juridiksionin e vet KSHK-ja, si dhe organizimin dhe drejtimin e KSHK-së, në bashkëpunim me ministritë përkatëse, institucionet e ndryshme të pushtetit qendror apo vendor dhe me organizatat jofitimprurëse, që veprojnë për zhvillimin, ofrimin dhe përdorimin e kualifikimeve.
- **Ligji Nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”**, ndryshuar me Ligjin nr. 9208, datë 18.03.2004 përcakton midis të tjerave kompetencat që ka pushteti vendor për arsimin parauniversitar.

## 4.2 Akte nënligjore

Përveç ligjeve, çështjet e statusit të mësuesit rregullohen edhe nëpërmjet akteve nënligjore, si vendime, urdhëra, udhëzime dhe rregullore të cilat paraqiten më poshtë.

- **Dispozitat Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar**, miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vitin 2013. Ky dokument përmban rregulla të hollësishme për procesin e mësimit dhe për aktorët që veprojnë në institucionet arsimore parauniversitare. Një kre i veçantë përmban rregulla për të drejtat dhe detyrat e mësuesit; për kohën e punës së mësuesit në institucionet arsimore publike; për planin vjetor lëndor të mësuesit; për projektet kurrikulare ndërlëndore/lëndore; për ditarin e mësuesit; për portofolin profesional të mësuesit; për shpërblimin e mësuesit; për procedurat e emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin arsimor publik; për mësuesit pa profilin përkatës; për zëvendësimin e mësuesit që mungon; për rolin e mësuesit kujdestar; për rolin e mësuesit ndihmës; për masat disiplinore për mësuesit. Në këtë dokument ka edhe disa pika që lidhen me vlerësimin individual të mësuesit.
- **“Kodi i etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar publik dhe privat” (2012)** miratuar nga MASH paraqet në mënyrë më të hollësishme qëllimet dhe parimet etike në shkollë. Kodi i etikës ofron modelin e sjelljes që shoqëria vlerëson dhe kërkon si të nevojshëm në mënyrë që shkolla të mund të realizojë misionin e saj shoqëror, për një shoqëri demokratike. Qëllimi i Kodit të Etikës është ndihmë mësuesin dhe punonjësit e tjerë të arsimit të njohin, të kuptojnë dhe të zbatojnë standardet etike të nevojshme për realizimin e misionit të arsimit dhe për të marrë vendime në kuadrin e realizimit të këtij misioni. Në këtë dokument paraqiten një sërë parimesh dhe rregullash etike të organizuara në dy pjesë: a) përkushtimi ndaj nxënësit dhe procesit të të nxënës; b) përkushtimi ndaj profesionit.

- **Udhëzim i MAS Nr.2, datë 05.02.2014 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”** përmban udhëzime për kriteret e kualifikimit, për procesin e kualifikimit, për detyrat e institucioneve të ndryshme për mbarëvajtjen e procesit të kualifikimit, për provimet e kualifikimit, për programet e kualifikimit, për testet e kualifikimit, zhvillimin dhe administrimin e provimeve, për mjediset e provimit, për vlerësimin, për certifikimin dhe ankimimit për procesin e kualifikimit dhe vlerësimin.
- **Udhëzim Nr.56, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar”.** Në këtë dokument përcaktohen procedurat dhe dokumentacioni për pranimin në punë të mësuesve, detyrat dhe puna e komisionit të vlerësimit, procedura e emërimit në punë të mësuesit nga drejtori, largimi i mësuesit nga puna.
- **Udhëzimi MASH Nr.11. datë 17.05.2013 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.** Në këtë dokument përcaktohen rregulla për zhvillimin profesional të punonjësve të arsimit, përfshirë edhe mësuesit. Udhëzimi përcakton procedurat për identifikimin e nevojave të zhvillimit profesional, rregulla për agjencitë trajnuese, për akreditimin e programeve të trajnimit, për provimet e agjencive trajnuese, për certifikatën e trajnimit, për rrjetet profesionale si formë e zhvillimit profesional, për seancat informuese të institucioneve të varësisë qendrore të MASH, për këshillimet për përhapjen e praktikave të suksesshme.
- **Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 952, datë 12.12.2012 “Për përjashtimin e profesionistit nga detyrimi për dhënien e provimit të shtetit për profesionet e rregulluara”.**
- **Programi i Praktikës Profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, miratuar nga MASH, datë 23.01.2011.** Ky dokument përmban qëllimin e praktikës profesionale, elemente kryesore të programit të praktikës profesionale, rregulla për vlerësimin e portofolit të praktikantit, vlerësimin e praktikantit.
- **Rregullore për sistemin e akreditimit të programeve të trajnimit, miratuar nga MASH më 09.03.2011.** Kjo rregullore përmban rregulla për agjencitë trajnuese, për format e trajnimit, për mënyrën e financimit të programeve të trajnimit, për funksionin e Komisionit të Akreditimit të Programeve të Trajnimit, për vendimet e Komisionit të Akreditimit të Programeve të Trajnimit, për vlerësimin e aplikimeve të agjencive trajnuese, për akreditimin.
- **Urdhëri i MASH Nr.336, datë 14.07.2011 “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”** përcakton synimet e praktikës, rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira në procesin e praktikës, procedurat e praktikës profesionale, dokumentacionin e praktikës, vlerësimin e praktikantit dhe procedurat e ankimimit.
- **Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 66, datë 03.02.2010 “Për riorganizimin e drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore”** i cili përcakton mënyrën e organizimit dhe detyrat e dy institucioneve vartëse të MAS.

- **Kontrata Kolektive e Punës e daës 25.05. 2010 për periudhën (2010-2014)**, e hartuar në bazë të Kodit të Punës përmban të gjitha të drejtat dhe detyrat për mësuesit, kushtet e punës, kohëzgjatjen e punës, lejen, pagën, rregullat etike dhe sanksionet.
- **Udhëzimi Nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e Arsimit Parauniversitar”**, i cili përcakton rregulla për ngarkesën mësimore të mësuesve.
- **Udhëzimi Nr.38, datë 09.10.2007 i MASH "Për zhvillimin e orëve të lira në shkollë"**, i cili përcakton rregulla për zhvillimin e orëve të lira në shkollë.
- **Udhëzimi Nr. 37, datë.09.10.2007 i MASH “Për paraqitjen e personelit të shkollës në mjediset shkollore”** përmban rregulla për mënyrën sesi duhet të paraqitet mësuesi në shkollë.
- **Udhëzimi Nr. 49, datë 27.12.2006 i MASH "Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve"** udhëzon mësuesit sesi duhet të hartojnë objektivat e arritjeve sipas niveleve të nxënësve.
- **Rregullore e MASH Nr. 8937, datë 22.12.2005 “Për shkollat me status “Shkolla të nivelit kombëtar”**. Në këtë rregullore përcaktohet statusi i shkollave kombëtare dhe statusi i mësuesve që punojnë në këto shkolla.

Tre vendimet e mëposhtme të Këshillit të Ministrave rregullojnë çështje të kohës së punës dhe pushimit, të pagave të mësuesve dhe të shpërblimit në bazë të kualifikimit.

- **Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërorë”**, i ndryshuar.
- **Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 194, datë 22.04.1999 “Për miratimin e strukturës së pagave të personelit mësimor në arsimin parauniversitar”**.
- **Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 537, datë 26.09.1994 “Për shtesë mbi pagën bazë për kualifikim të mësuesve dhe shtesë për veprimtari të inspektorëve të arsimit”**.

Nga paraqitja e mësipërme del e qartë se baza ligjore mbulon pothuajse gjithë aspektet e profesionit të mësuesit, si: statusi, kualifikimet, punësimi, paga, zhvillimi profesional, trajnimi, të drejtat, detyrat dhe promovimi.

Vërehet se meqë Shqipëria aspron të bëhet anëtare e Bashkimit Europian, i ka kushtuar një vemendje të madhe përgatitjes dhe miratimit të një sërë dokumentesh ligjore. Gjithashtu vërehet se kur ndërmerren nisma për ndryshimin e legjislacionit nuk respektohet parimi i konsistencës ndërmjet dokumenteve të ndryshme ligjore në mënyrë që ato të mos bien ndesh me njëri-tjetrin, veçanërisht kur bëhen ndryshime të pjesshme ose sektoriale të legjislacionit përkatës.

### 4.3 Kuadri institucional dhe rregullator për profesionin e mësuesit

Në Shqipëri egzistojnë një sërë institucionesh dhe organizmash, të cilat veprojnë për të zbatuar legjislacionin që lidhet me çështjet e profesionit të mësuesit.

#### Për përgatitjen e mësuesve

Institucionet përgjegjëse për përgatitjen e mësuesve janë:

- **Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)** përcakton politikat për programet universitare
- **Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL)** ofrojnë programe studimi Bachelor, Master në Mësuesi, si dhe Doktorata në Pedagogji.
- **Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL)** përgjigjet për sigurimin e cilësisë së programeve universitare dhe të Institucioneve të Arsimit të Lartë.

#### Për fitimin e të drejtës së ushtrimit të profesionit

Institucionet dhe autoritet përgjegjëse për dhënien e të drejtës së ushtrimit të profesionit të mësuesit janë:

- **Këshilli i Ministrave (KM)**, i cili me propozimin e autoritetit kompetent përcakton kërkesat minimale për formimin dhe kualifikimet profesionale për profesionet e rregulluara dhe listën e specialiteteve, të nënspecialiteteve apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara.
- **Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)** si autoriteti kompetent për profesionin e rregulluar të mësuesit, miraton programet e praktikës profesionale, siguron dhe monitoron kryerjen e praktikës, i përcjell AKP listën e personave të përshtatshtëm për provimin e shtetit.
- **Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP)** që përgjigjet për organizimin e provimit të shtetit të mësuesve.
- **Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL)** që përgatisin programet orientuese për provimin e shtetit.
- **Drejtoritë Arsimore Rajonale /Zyrat Arsimore (DAR/ZA)** përgjigjen për zhvillimin e praktikës profesionale në shkollat që mbulojnë, organizojnë sistemin e mentorimit, pajisin praktikantët me certifikatën e praktikës.
- **Institucionet Arsimore Publike dhe Private (IAP/P)** ndjekin veprimtarinë e mentorëve dhe të praktikantëve në institucionet e tyre, vlerësojnë praktikantin.



## Për kualifikimin e mësuesve


Institucionet përgjegjëse për procesin e kualifikimit të mësuesve në sistemin e arsimit parauniversitar janë të përcaktuara në **Udhëzimin e MAS Nr.2, datë 05.02.2014 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”**. Sipas këtij udhëzimi institucionet përgjegjëse janë: Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore (DAR/ZA).

- **Ministria e Arsimit dhe Sportit (Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme)** përgjigjet për drejtimin e procesit të kualifikimit dhe monitorimin e zhvillimit të provimeve.
- **Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA)** administron procesin e kualifikimit të mësuesve ka përgjegjësi për hartimin e programeve të kualifikimit, për hartimin e fondit të pyetjeje të provimit të kualifikimit; për hartimin e testit; për masat administrative për zhvillimin e provimit të kualifikimit; për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit të testit; për vlerësimin e testit, për lëshimin e certifikatës së kualifikimit, për raportimin e rezultateve të kualifikimit, për dhënien e rekomandimeve MAS për politikat dhe planet e zhvillimit profesional të personelit arsimor.
- **Drejtoria Arsimore Rajonale /Zyra Arsimore (DAR/ZA)** kanë përgjegjësi për të informuar kandidatët për procedurat dhe rregullat e procesit të kualifikimit; për ndjekjen e aplikimeve; për vlerësimin e portofoleve të kandidatëve; për përcjelljen në IZHA të listës emërore të kandidatëve; për regjistrimin e të dhënave të kualifikimit; për organizimin e Konferencës vjetore rreth provimeve të kualifikimit në qarkun përkatës; për përmirësimin e planit të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë mbështetur në rezultatet e provimeve.

## Për zhvillimin e vazhdueshëm profesional

- **Drejtuesit e shkollës (DSH)** kanë përgjegjësi për trajnimin dhe kualifikimin e stafit të personelit të shkollës. Nevojat për zhvillim profesional për të gjithë personelin stafin identifikohen në kohë dhe më pas përcaktohet plani i zhvillimit profesional. Mbahen parasysh nevojat e shkollës, të ekipeve kurrikulare, si dhe nevojat individuale të mësuesve.
- **Drejtoria Arsimore Rajonale /Zyra Arsimore (DAR/ZA)** kanë përgjegjësi për të mbështetur zhvillimin profesional

**Fig. 1 SKEMA INSTITUCIONALE PËR FORMIMIN, ZHVILLIMIN PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMIN E MËSUESVE**



#### **4.4 Politika për zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe vlerësimin e mësuesve**

Nga viti 2004 deri në vitin 2013 politika për formimin, zhvillimin profesional dhe kualifikimin e mësuesve është paraqitur në dy dokumente themelore: Strategjia e Arsimit Parauniversitar (2004-2015/ 2009-2013) dhe Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë (2008-2013).

Strategjia e Arsimit Parauniversitar parashikonte masa dhe nisma për zhvillimin e profesionit të mësimdhënies duke fuqizuar Qendrën e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin, përmirësimin e kurrikulës për trajnimin e mësuesve, parashikimin e skemave motivuese të punësimit të bazuara në meritat, regjistrimin e mësuesve, sigurimin e cilësisë së trajnimit të mësuesve<sup>3</sup>.

Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë 2008-2013 parashikonte ndryshime për kurrikulat e përgatitjes së mësuesve, ngritjen e një sistemi vlerësimi për veprimtarinë mësimdhënëse të mësuesve, përmes të cilit do të përcaktohen nevojat e tyre për trajnim. Në Planin e veprimit parashikohej rritja e nivelit të financimit për trajnimin në shërbim dhe ndryshimin e mënyrës së financimit të këtij trajnimi. Metoda e re shihej si më afër tregut të punës, ku fondet publike u viheshin në disponim përfituesve të trajnimit dhe jo ofruesve të këtij shërbimi.<sup>4</sup>

Arritja kryesore e reformës së bazuar në këto dy dokumente është përfshirja e profesionit të mësuesit në profesionet e rregulluara. Politikat e ndërmarra reformuan sistemin e përgatitjes së mësuesve duke ndryshuar strukturën kurrikulare, por nuk u arrit përafrimi i kurrikulave të Institucioneve të Arsimit të Lartë, për shkak të qasjeve të ndryshme që përzgjidhën ato<sup>5</sup>. U ndryshua skema e trajnimeve, duke përcaktuar programet, kriteret, kreditet e kërkuara dhe duke e liberalizuar tregun e trajnimeve.

Aktualisht, MAS është duke ideuar ndryshime për sistemin e përgatitjes së mësuesve. Raporti Përfundimtar për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor i paraqitur në korrik 2014 propozon këto ndryshime në politikat që lidhen me profesionin e mësuesit :

- Mësuesit e arsimit parashkollor dhe të atij fillor duhet të formohen nga studime Bachelor 3-vjeçare me 180 kredite, me kurrikula të ndërtuara për këtë cikël. Pas këtyre studimeve, studentët mund të kalojnë në tregun e punës si mësues ndihmës, pasi kanë marrë të drejtën e ushtrimit të profesionit (pas provimit të licensimit).
- Programi i ciklit të dytë të studimeve Master Profesional 1-vjeçar, me 60 kredite, duhet të dallohet në Master Profesional që përgatit mësues për arsimin parashkollor, ose në Master Profesional për arsimin fillor. Pas fitimit të diplomës së ciklit të dytë, të diplomuarit, sipas titullit përkatës të diplomës, mund të kalojnë në

<sup>3</sup> Strategjia e Arsimit Parauniversitar 2004-2015, Tiranë 2004, fq. 15.

<sup>4</sup> Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë 2008-2013, Tiranë.

<sup>5</sup> Raporti Përfundimtar për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Tiranë 2014

tregun e punës si mësues, pasi kanë marrë të drejtën e ushtrimit të profesionit (pas provimit të licensimit).

- Mësuesit e arsimit të mesëm duhet të përgatiten duke ndjekur këtë rrugë: Diplomim në fushën përkatëse të shkencës (cikli i parë: diplomë Bachelor 3-vjeçare, 180 kredite), Studime të ciklit të dytë, Master i Shkencave 2-vjeçar 120 kredite, i cili përgatit mësues për arsimin e mesëm të ulët dhe atë të lartë.
- Kurrikulat e programeve të studimit të ciklit të dytë për përgatitjen e mësuesve duhet të ruajnë një ngjashmëri në nivel kombëtar sipas fushës së shkencës përkatëse në masën 80%.
- Kurrikulat e programeve të ciklit të dytë të studimeve për formimin e mësuesve duhet të kenë përbërës të rëndësishëm të formimit pedagogjik dhe psikologjik, si edhe të formimit praktik pranë institucioneve të arsimit të mesëm.
- Kjo reformë propozon që viti i praktikës në shkollë, pas diplomimit të studentëve me diplomën e ciklit të dytë, pranë Institucioneve të Arsimit të Mesëm, të bëhet me ½ e rrogës së mësuesit (sikundër ndodh edhe me stazhierët e mjekësisë).
- Formimi i mësuesve duhet të jetë i vazhduar. Institucionet e Arsimit të Lartë duhet të krijojnë kushte për trajnimin dhe formimin e vazhduar të mësuesve në bashkëpunim me Institucionet e Arsimit të Mesëm.<sup>6</sup>

---

<sup>6</sup> Raporti përfundimtar për reformimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, Tiranë korrik 2014, fq.47.

## 5. Situata aktuale e zhvillimit profesional dhe vlerësimit të mësuesve në Shqipëri

Një ndër qëllimet kryesore të vlerësimit ishte krijimi i një tabloje të qartë për zhvillimin profesional dhe vlerësimin e mësuesve në Shqipëri, si një mundësi për të bërë një vlerësim të situatës dhe të rekomandonte zgjidhje praktike për përmirësimin e sistemit.

Ministria e Arsimit dhe Sportit boton çdo vit “Vjetarin Statistikor për Arsimin”, dokument që, ndër të tjera, përmban të dhëna edhe për mësuesit në Shqipëri, të cilët janë pjesë e sistemit të arsimit publik dhe privat. Më poshtë paraqiten të dhënat statistikore për mësuesit nga viti 2004-2012 bazuar në “Vjetari statistikor për arsimin 2011-2012 dhe seri kohore, botim i MASH i vitit 2013.

Të dhënat japin informacion për numrin e përgjithshëm të mësuesve në nivel vendi, për numrin e mësuesve sipas sektorëve publik dhe privat; sipas gjinisë, sipas DAR; sipas vendndodhjes së shkollës, sipas nivelit të shkollimit të mësuesve; sipas hallkës së arsimit ku japin mësim.

Nga të dhënat e treguesve vërehet:

- a. Numri i mësuesve në arsimin parashkollor dhe arsimin e mesëm është rritur, ndërsa numri i mësuesve në arsimin bazë ka pësuar rënie. Kjo shpjegohet me faktin se arsimi parashkollor dhe arsimi i mesëm kanë patur më shumë zhvillim këto 10 vitet e fundit. Është shtuar numri i fëmijëve që frekuentojnë kopshtin dhe i nxënësve që ndjekin shkollën e mesme dhe për rrjedhojë është rritur edhe numri i mësuesve në këto dy nivele të shkollimit.
- b. Numri i mësuesve me arsim të lartë ka ardhur duke u rritur, kjo si rezultat i kërkesave për mësues më cilësorë në shkolla.
- c. Numri i mësuesve me arsim të lartë është më i madh në arsimin privat. Sektori privat ka tregues më të mirë për nivelin e shkollimit të mësuesve. Kjo shpjegohet me kërkesat e larta të prindërve, të cilët paguajnë për arsimimin e fëmijëve të tyre, me angazhimin e shkollave private për përmbushjen e standardeve të kërkuara.
- d. Shumica e mësuesve në arsimin bazë dhe të mesëm janë femra dhe se asnjë mashkull nuk është i punësuar në arsimin parashkollor. Pra, mësuesia vazhdon të jetë një profesion femëror. Vërehet se ka një mungesë të balancës gjinore në personelin e punësuar në sistemin arsimor. Po ashtu vazhdon tradita e edukatoreve femra në arsimin parashkollor. Kjo lidhet edhe me mentalitetin se kujdesi për fëmijet e vegjël është një çështje që u takon vajzave dhe grave.
- e. Numri i mësuesve në fshat është më i vogël sesa në qytet, fakt që lidhen me numrin e nxënësve në fshat dhe me lëvizjen e popullsisë nga zonat rurale në zonat urbane.




## 5.1 Të dhëna të përgjithshme për mësuesit në Shqipëri

Më poshtë po paraqesim një tablo të të dhënave të përgjithshme në lidhje me edukatorët dhe mësuesit në Shqipëri, nga viti 2004 e deri në vitin shkollor 2013.

**Tab.1 Numri i edukatoreve në arsimin parashkollor (deri në vitit 2013)**

Arsimi parashkollor: numri i edukatoreve				
Viti shkollor	Arsimi publik		Arsimi privat	
	Numri i edukatoreve		Numri i edukatoreve	
	Gjithsej	Fshat	Gjithsej	Fshat
2004-2005	3502	1651	230	24
2005-2006	3643	1723	230	22
2006-2007	3546	1631	227	20
2007-2008	3651	1836	232	25
2008-2009	3739	1744	210	28
2009-2010	3919	1773	225	29
2010-2011	3825	1822	222	41
2011-2012	4083	1907	266	38

**Fig. 2 Numri i edukatoreve të arsimit parashkollor**




Tab.2 Numri i edukatoreve sipas DAR/ZA


Arsimi parashkollor: numri i edukatoreve sipas DAR/ZA për vitin shkollor 2011-2012				
DAR/ZA	Arsimi publik		Arsimi privat	
	Numri i edukatoreve		Numri i edukatoreve	
	Gjithsej	Fshat	Gjithsej	Fshat
Berat	167	83	13	0
Buqizë	54	31	0	0
Delvinë	25	14	0	0
Devoll	59	46	0	0
Dibër	119	70	0	0
Durrës	175	65	24	0
Elbasan	265	122	23	4
Fier	224	118	6	0
Gramsh	65	41	0	0
Gjirokastrë	67	15	10	1
Has	28	19	0	0
Kamëz	136	53	1	0
Kavajë	96	55	3	0
Kolonjë	27	13	0	0
Korçë	229	120	11	0
Krujë	68	24	3	3
Kuçovë	54	19	1	0
Kukës	101	50	0	0
Kurbin	72	25	3	3
Lezhë	91	56	15	6
Librazhd	103	67	0	0
Lushnje	181	120	12	6
Malësi e Madhe	51	39	7	2
Mallkastër	48	30	0	0
Mat	87	49	0	0
Mirditë	46	19	0	0
Peqin	36	28	2	0
Përmet	31	12	0	0
Pogradec	144	88	6	4
Pukë	56	36	0	0
Sarandë	57	25	14	0
Skrapar	45	13	0	0
Shkodër	151	69	24	6
Tepelenë	63	26	0	0
Tiranë Qytet	397	0	66	0
Tiranë Rreth	161	140	3	3
Tropojë	54	24	0	0
Vlorë	250	83	19	0
Total	<b>4083</b>	<b>1907</b>	<b>266</b>	<b>38</b>

**Tab.3 Numri i mësuesve në arsimin bazë**


Arsimi bazë: numri i mësuesve												
Viti shkollor	Mësues gjithsej				Arsimi publik				Arsimi privat			
	Mësues gjithsej		Mësues në fshat		Mësues gjithsej		Mësues në fshat		Mësues gjithsej		Mësues në fshat	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
2004-2005	27110	17847	16256	9235	25862	16820	16164	9160	1248	1027	92	75
2005-2006	27157	18245	16368	9413	25670	17021	16097	9241	1487	1224	271	172
2006-2007	26540	18138	15250	8969	24943	16819	15091	8837	1597	1319	159	132
2007-2008	26102	18101	14903	8910	24418	16732	14740	8779	1684	1369	163	131
2008-2009	27724	19503	15631	9597	25784	17894	15451	9454	1940	1609	180	143
2009-2010	27241	19200	15276	9401	25243	17564	15097	9260	1998	1636	179	141
2010-2011	25973	18628	14429	9107	24063	17018	14266	8972	1910	1610	163	135
2011-2012	25584	18431	14293	9058	23660	16816	14154	8941	1924	1615	139	117



**Fig.3 Numri i mësuesve në arsimin bazë**



**Fig.4 Numri i mësuesve në arsimin bazë publik dhe privat**



**Fig. 5 Numri i mësuesve në arsimin bazë sipas gjinisë**

**Tab.4 Numri i mësuesvenë arsimin bazë sipas gjinisë, vendndodhjes së shkollës për vitin shkollor 2011-2012 sipas DAR/ZA për vitin shkollor 2011-2012**

Arsimi bazë: numri i mësuesve sipas gjinisë, vendndodhjes së shkollës për vitin shkollor 2011-2012 sipas DAR/ZA për vitin shkollor 2011-2012												
DAR/ZA	Mësues				Publik				Privat			
	Gjithsej		Fshat		Gjithsej		Fshat		Gjithsej		Fshat	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Berat	929	636	583	353	899	615	583	353	30	21	0	0
Buqizë	329	220	245	149	329	220	245	149	0	0	0	0
Delvinë	126	84	78	49	126	84	78	49	0	0	0	0
Devoll	232	178	182	133	232	178	182	133	0	0	0	0
Dibër	724	418	592	318	724	418	592	318	0	0	0	0
Durrës	1559	1122	628	349	1359	944	611	334	200	178	17	15
Elbasan	1681	1220	1038	674	1657	1199	1038	674	24	21	0	0
Fier	1580	1247	927	682	1417	1103	920	679	163	144	7	3
Gramsh	359	232	264	154	359	232	264	154	0	0	0	0
Gjirokastrë	345	276	152	105	324	255	152	105	21	21	0	0
Has	187	127	146	91	187	127	146	91	0	0	0	0
Kamëz	853	590	340	223	833	571	340	223	20	19	0	0
Kavajë	624	436	404	250	604	421	404	250	20	15	0	0
Kolonjë	135	80	84	43	135	80	84	43	0	0	0	0
Korçë	1056	777	615	418	1003	736	615	418	53	41	0	0
Krujë	560	376	366	215	546	364	355	206	14	12	11	9
Kuçovë	237	181	116	78	226	174	116	78	11	7	0	0
Kukës	596	359	427	218	596	359	427	218	0	0	0	0
Kurbin	423	313	196	134	406	300	191	130	17	13	5	4
Lezhë	582	435	404	280	533	388	375	252	49	47	29	28
Librazhd	684	472	569	370	684	472	569	370	0	0	0	0
Lushnje	1105	820	828	588	1045	776	828	588	60	44	0	0
Malësi e Madhe	331	210	260	158	326	206	260	158	5	4	0	0
Mallkastër	299	213	203	134	288	206	203	134	11	7	0	0
Mat	503	350	358	225	502	350	358	225	1	0	0	0
Mirditë	284	199	180	121	284	199	180	121	0	0	0	0
Peqin	267	185	214	138	267	185	214	138	0	0	0	0

<b>Përmet</b>	207	103	121	42	207	103	121	42	0	0	0	0
<b>Pogradec</b>	619	423	452	289	563	378	406	250	56	45	46	39
<b>Pukë</b>	242	176	179	126	242	176	179	126	0	0	0	0
<b>Sarandë</b>	252	202	128	93	243	193	128	93	9	9	0	0
<b>Skrapar</b>	222	112	136	53	222	112	136	53	0	0	0	0
<b>Shkodër</b>	1705	1282	860	575	1473	1089	860	575	232	193	0	0
<b>Tepelenë</b>	308	190	214	112	308	190	214	112	0	0	0	0
<b>Tiranë Qytet</b>	2762	2368	0	0	2022	1738	0	0	740	630	0	0
<b>Tiranë Rreth</b>	1090	644	1053	617	1066	625	1029	598	24	19	24	19
<b>Tropojë</b>	332	222	261	165	332	222	261	165	0	0	0	0
<b>Vlorë</b>	1255	953	490	336	1091	828	490	336	164	125	0	0
<b>Total</b>	<b>25584</b>	<b>18431</b>	<b>14293</b>	<b>9058</b>	23660	16816	14154	8941	1924	1615	139	117

**Tab.5 Numri i mësuesve në arsimin bazë në vite sipas gjinisë dhe vendndodhjes së shkollës**

<b>Arsimi i mesëm: numri i mësuesve në vite sipas gjinisë dhe vendndodhjes së shkollës</b>												
Viti shkollor	Mësues gjithsej				Arsimi publik				Arsimi privat			
	Mësues gjithsej		Mësues në fshat		Mësues gjithsej		Mësues në fshat		Mësues gjithsej		Mësues në fshat	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
<b>2004-2005</b>	7384	4225	1795	781	6337	3617	1752	759	1047	608	43	22
<b>2005-2006</b>	7997	4673	1857	822	6753	3936	1836	813	1244	737	21	9
<b>2006-2007</b>	8424	4925	2031	928	7113	4164	1993	908	1311	761	38	20
<b>2007-2008</b>	8761	5237	2086	1094	7405	4468	2026	1065	1356	769	60	29
<b>2008-2009</b>	8046	4875	2004	982	6649	4030	1922	941	1397	845	82	41
<b>2009-2010</b>	8250	5080	2019	1032	6858	4215	1968	1001	1392	865	51	31
<b>2010-2011</b>	8179	5088	2052	1064	6702	4145	1948	1001	1477	943	104	63
<b>2011-2012</b>	8473	5295	2178	1154	6907	4316	2068	1090	1566	979	110	64



**Tab.6: Numri i mësuesve në arsimin e mesëm sipas gjinisë, vendndodhjes së shkollës për vitin shkollor 2011-2012**


DAR/ZA	Arsimi i Mesëm: Numri i mësuesve sipas gjinisë, vendndodhjes së shkollës për vitin shkollor 2011-2012											
	Mësues				Publik				Privat			
	Gjithsej		Fshat		Gjithsej		Fshat		Gjithsej		Fshat	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Berat	318	171	101	51	303	164	101	51	15	7	0	0
Buqizë	60	33	30	11	60	33	30	11	0	0	0	0
Delvinë	32	17	18	9	14	8	0	0	18	9	18	9
Devoll	60	35	29	17	60	35	29	17	0	0	0	0
Dibër	132	58	54	21	132	58	54	21	0	0	0	0
Durrës	562	380	136	79	404	267	99	53	158	113	37	26
Elbasan	565	366	135	86	510	337	135	86	55	29	0	0
Fier	504	326	125	79	339	219	121	78	165	107	4	1
Gramsh	88	39	44	17	88	39	44	17	0	0	0	0
Gjirokastrë	177	112	50	41	169	111	50	41	8	1	0	0
Has	34	17	6	1	34	17	6	1	0	0	0	0
Kamëz	213	133	56	31	206	127	56	31	7	6	0	0
Kavajë	168	96	42	28	127	81	42	28	41	15	0	0
Kolonjë	35	20	6	3	35	20	6	3	0	0	0	0
Korçë	376	201	85	39	320	173	85	39	56	28	0	0
Krujë	104	66	27	11	104	66	27	11	0	0	0	0
Kuçovë	86	56	16	11	77	52	16	11	9	4	0	0
Kukës	135	72	64	21	132	70	64	21	3	2	0	0
Kurbin	112	74	14	7	107	70	14	7	5	4	0	0
Lezhë	215	137	101	52	196	124	101	52	19	13	0	0
Librazhd	155	73	94	45	155	73	94	45	0	0	0	0
Lushnje	357	220	166	97	310	191	166	97	47	29	0	0
Malësi e Madhe	89	48	32	18	77	42	32	18	12	6	0	0
Mallkastër	65	35	19	12	41	26	19	12	24	9	0	0
Mat	135	81	47	26	134	81	47	26	1	0	0	0
Mirditë	85	49	14	6	85	49	14	6	0	0	0	0
Peqin	47	37	24	18	47	37	24	18	0	0	0	0
Përmet	59	20	17	3	59	20	17	3	0	0	0	0
Pogradec	201	115	105	57	177	98	81	40	24	17	24	17
Pukë	63	38	27	10	63	38	27	10	0	0	0	0
Sarandë	74	47	13	2	68	43	13	2	6	4	0	0

<b>Skrapar</b>	54	30	5	1	54	30	5	1	0	0	0	0
<b>Shkodër</b>	647	398	110	52	463	280	110	52	184	118	0	0
<b>Tepelenë</b>	65	28	25	8	65	28	25	8	0	0	0	0
<b>Tiranë Qytet</b>	1596	1192	0	0	1035	811	0	0	561	381	0	0
<b>Tiranë Rreth</b>	269	147	219	115	227	127	192	104	42	20	27	11
<b>Tropojë</b>	69	38	36	22	69	38	36	22	0	0	0	0
<b>Vlorë</b>	467	290	86	47	361	233	86	47	106	57	0	0
<b>Total</b>	<b>8473</b>	<b>5295</b>	<b>2178</b>	<b>1154</b>	<b>6907</b>	<b>4316</b>	<b>2068</b>	<b>1090</b>	<b>1566</b>	<b>979</b>	<b>110</b>	<b>64</b>


**Tab.7 Numri i mësuesve në arsimin parauniversitar dhe niveli i arsimimit**

Viti shkollor	Numri i mësuesve në arsimin parauniversitar dhe niveli i arsimimit					
	Gjithsej		Arsim public		Arsim privat	
	Me arsim të mesëm	Me arsim të lartë	Me arsim të mesëm	Me arsim të lartë	Me arsim të mesëm	Me arsim të lartë
<b>2004-2005</b>	13693	24552	13416	22285	277	2267
<b>2005-2006</b>	13311	25716	13017	23049	294	2667
<b>2006-2007</b>	12573	26164	12288	23314	285	2850
<b>2007-2008</b>	11123	27623	10814	24660	309	2963
<b>2008-2009</b>	10384	29335	10114	26058	270	3277
<b>2009-2010</b>	9555	30080	9266	26754	289	3326
<b>2010-2011</b>	7686	30513	7447	27143	239	3370
<b>2011-2012</b>	7214	31192	6988	27662	226	3530


**Fig. 6 Mësues gjithsej në arsimin parauni.**



**Fig. 7 Mësues në arsimin parauniversitar publik**



**Fig. 8 Mësues në arsimin parauniversitar privat**




Tregues të tjerë që vlen të analizohen janë ata që lidhen me nivelin e shkollimit të mësuesve. Nëse do t'i referohemi treguesve të tabelave 7 dhe 8 vërejmë se në vitin 2011-2012 rreth 20.2% e mësuesve në arsimin publik dhe 6% e mësuesve në arsimin privat janë ende me arsim të mesëm. Arsimi parashkollor ka përqindjen më të madhe të mësuesve me arsim të mesëm. Shifra 41% e edukatoreve me arsim të mesëm në arsimin publik në vitin 2011-2012 është një tregues domethënës për cilësinë e arsimit parashkollor. Por edhe shifra 21, 8% e mësuesve me arsim të mesëm në arsimin bazë në sektorin publik është dëshmi për cilësinë e mësuesve. Megjithatë rritja e numrit të mësuesve me arsim të lartë është një prirje pozitive dhe në vijimësi. Grafikët e paraqitur më poshtë e ilustronjë qartë këtë prirje.


**Tab.8 Numri i mësuesve në arsimin parauniversitar dhe niveli i arsimimit**

	Arsim publik		Arsim privat	
	Me arsim të mesëm (%)	Me arsim të lartë (%)	Me arsim të mesëm (%)	Me arsim të lartë (%)
2004-2005	<b>38</b>	<b>62</b>	<b>11</b>	<b>89</b>
Edukatore në kopshte	69	31	59	41
Mësues në arsimin bazë	41	59	14	86
Mësues në arsimin e mesëm	4	96	1	99
2005-2006	<b>36</b>	<b>64</b>	<b>10</b>	<b>90</b>
Edukatore në kopshte	70	30	43	57
Mësues në arsimin bazë	40	60	12	88
Mësues në arsimin e mesëm	3	97	1	99
2006-2007	<b>34</b>	<b>66</b>	<b>9</b>	<b>91</b>
Edukatore në kopshte	66	34	42	58
Mësues në arsimin bazë	39	61	11	89
Mësues në arsimin e mesëm	4	96	1	99
2007-2008	<b>30</b>	<b>70</b>	<b>9</b>	<b>91</b>
Edukatore në kopshte	60	40	36	64
Mësues në arsimin bazë	34	66	13	87
Mësues në arsimin e mesëm	3	97	1	99
2008-2009	<b>28</b>	<b>72</b>	<b>8</b>	<b>92</b>
Edukatore në kopshte	54	46	28	72
Mësues në arsimin bazë	31	69	9	91
Mësues në arsimin e mesëm	3	97	0	100
2009-2010	<b>25.7</b>	<b>74.3</b>	<b>8</b>	<b>92</b>
Edukatore në kopshte	49	51	26	74
Mësues në arsimin bazë	29	71	11	89
Mësues në arsimin e mesëm	2.2	97.8	0.5	99.5
2010-2011	<b>21.5</b>	<b>78.5</b>	<b>6.6</b>	<b>93.4</b>
Edukatore në kopshte	44.5	55.5	21.6	78.4
Mësues në arsimin bazë	23.3	76.7	9.5	90.5
Mësues në arsimin e mesëm	1.9	98.1	0.6	99.4
2011-2012	<b>20.2</b>	<b>79.8</b>	<b>6</b>	<b>94</b>
Edukatore në kopshte	41	59	21.8	78.2
Mësues në arsimin bazë	21.8	78.2	8.1	91.9
Mësues në arsimin e mesëm	2.2	97.8	0.8	99.2


**Fig.9 Numri i edukatoreve të kopshtit në arsimin publik sipas nivelit të arsimimit (%)**




**Fig.10 Numri i edukatoreve të kopshtit në arsimin privat sipas nivelit të arsimimit (%)**




**Fig. 11** Numri i mësuesve të arsimit bazë në arsimin publik sipas nivelit të arsimit




**Fig. 12** Numri i mësuesve të arsimit bazë në arsimin privat sipas nivelit të arsimit



**Fig. 13** Numri i mësuesve të arsimit të mesëm në arsimin publik sipas nivelit të arsimit



**Fig. 14** Numri i mësuesve të arsimit të mesëm në arsimin privat sipas nivelit të arsimit



## 5.2. Praktika për zhvillimin profesional dhe vlerësimin e mësuesve

### 5.2.1 Praktika që lidhen me të drejtën e ushtrimit të profesionit

Në vitin 2011, MASH në zbatim të nismës për garantimin e cilësisë së mësuesve dhe në zbatim të detyrave të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit Parauniversitar dhe Strategjinë Kombëtarë të Arsimit të lartë, përcaktoi një politikë të re për pranimin e mësuesve në sistemin arsimor të mbështetur në Ligjin për Profesionet e Rregulluara. Në kuadrin e kësaj politike kandidatët për mësues duhet të kryejnë një vit shkollor praktikë pedagogjike në shkollat e arsimit bazë ose të mesëm.

Për të realizuar praktikën u parashikua ngritja e sistemit të mentorëve, të cilët do të asistojnë kandidatët për mësues gjatë vitit të praktikës. U përcaktuan gjithashtu modalitetet për provimin e shtetit. Realizimi i praktikës ka ndeshur në një sërë vështirësish që lidhen kryesisht me mentorimin dhe mbështetjen financiare. Universitetet nuk janë të përfshira në procesin e praktikës, por ato duhet të bashkëpunojnë me IZHA dhe AKP për programet e praktikës dhe të provimit të shtetit.

### 5.2.2 Praktika që lidhen me kualifikimin e mësuesve

Të gjithë mësuesit e sistemit parauniversitar i nënshtrohen kualifikimit. Kualifikimi bëhet nëpërmjet portofolit personal të zhvillimit profesional dhe provimeve përkatëse. Provimet realizohen mbi bazën e programeve të kualifikimit për mësuesit në arsimin parauniversitar, mësuesit në arsimin 9-vjeçar, cikli fillor, mësuesit në arsimin 9-vjeçar, cikli i lartë, për lëndët: gjuhë shqipe, anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, edukim fizik, edukim muzikor, edukim figurative si dhe lëndë të tjera specifike brenda sistemit arsimor; mësuesit në gjimnaz dhe mësuesit e kulturës së përgjithshme të shkollave profesionale, social-kulturore dhe speciale; mësuesit e kulturës profesionale në arsimin profesional: test i përgjithshëm; mësuesit e kulturës profesionale në shkollat artistike: test i përgjithshëm, mësuesit e kulturës profesionale në shkollat speciale: test i përgjithshëm.

Kualifikimi i mësuesve bëhet sipas tri kategorive: kategoria e parë, mësues mjeshtër, vjetërsia nga 20 e në shumë vjet; kategoria e dytë mësues specialist, vjetërsia nga 10 deri 19 vjet; kategoria e tretë, mësues i kualifikuar, vjetërsia nga 5 deri 9 vjet.

Të gjithë mësuesit e sistemit parauniversitar i nënshtrohen kualifikimit. Kualifikimi bëhet nëpërmjet portofolit personal të zhvillimit profesional dhe provimeve përkatëse. Kualifikimi i vazhduar zhvillohet në dy etapa:

**Etapa e parë:** Përgatitja e Portofolit Profesional të mësuesit, i cili përmban CV, dokumente dhe çertifikata të fituara gjatë periudhës në fjalë si dhe pjesën e dokumenteve profesionale, si: një plan mësimor vjetor për një lëndë e klasë të caktuar; një test kapitulli; objektivat e arritjeve të nxënësve për një kapitull në tri nivele në një lëndë dhe klasë të caktuar; një planifikim ditor sipas një strukture të plotë, në të cilin përfshihen edhe metodat e realizimit

të objektivave të orës së mësimi; një plan të projektit kurrikular së bashku me përshkrimin e realizimit të tij.. Portofoli vlerësohet nga një komision i ngritur pranë DAR/ZA ku mësuesi punon.

**Etapa e dytë:** Testimi i mësuesit. Në këtë etapë kalojnë mësuesit që kanë paraqitur portofolin dhe janë vlerësuar mbi një numër minimal pikësh. Mësuesit i nënshtrohen provimit mbi bazën e një testi. Provimet realizohen mbi bazën e programeve të kualifikimit për mësuesit në arsimin parauniversitar, mësuesit në arsimin 9-vjeçar, cikli fillor, mësuesit në arsimin 9-vjeçar, cikli i lartë, për lëndët: gjuhë shqipe, anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, edukim fizik, edukim muzikor, edukim figurative si dhe lëndë të tjera specifike brenda sistemit arsimor; mësuesit në gjimnaz dhe mësuesit e kulturës së përgjithshme të shkollave profesionale, social-kulturore dhe speciale; mësuesit e kulturës profesionale në arsimin profesional: test i përgjithshëm; mësuesit e kulturës profesionale në shkollat artistike: test i përgjithshëm, mësuesit e kulturës profesionale në shkollat speciale: test i përgjithshëm.

Vlerësimi përfundimtar mbështetet në kreditet e grumbulluara dhe rezultatet e testimit. Nëpërmjet këtij sistemi diferencohet paga e mësuesve sipas meritës profesionale. Nga të dhënat e mëposhtme vërehet se numri më i madh mësuesve i përket kualifikimit të shkallës së tretë.

Treguesit e vlerësimit dëshmojnë se shumica e mësuesve si në vitin 2012 edhe në vitin 2013 kanë marrë vlerësimin “mirë” (C). Ky tregues flet për një cilësi mesatare të mësuesve. Në vitin 2012, 2,8% e mësuesve nuk e ka fituar provimin e kualifikimit, ndërsa në vitin 2013 nuk e ka fituar 3,1% e mësuesve.

### 5.2.3 Praktika që lidhen me zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve

Ky lloj vlerësimi është kryesisht kompetencë e drejtuesve të shkollave. Shkollat nuk kanë statistika lidhur me vlerësimin e performancës. Rezultatet e vlerësimit të performancës për përmirësim mbahen nga drejtuesit e shkollës dhe rrallë herë ato gjenden në dosjet personale të mësuesve. Lidhur me këtë lloj vlerësimi nuk ka të dhëna në nivel kombëtar.

**Tab. 9 Të dhëna për kualifikimin e mësuesve**

Viti	Numri i mësuesve të regjistruar	Femra	Meshkuj	Kategoria I Mësues mjeshër	Mësues specialist	Kategoria III Mësues i kualifikuar	Vlerësimi A shkëlqyeshëm	Vlerësimi B shumë mirë	Vlerësimi C mirë	Vlerësimi D mjaftueshëm	Vlerësimi E dobët	Nuk u paraqit
2012	3142	2585	557	845	844	1453	93	1078	1542	263	89	77
2013	3915	3187	728	1307	1243	1665	99	1223	2060	337	125	71



### 5.3 Problematika për zhvillimin profesional dhe vlerësimin e mësuesve

Mbështetur në një vlerësim të të gjithë të dhënave që lidhen me sistemet e vlerësimit të mësuesve në Shqipëri, por edhe në intervistat dhe fokus grupet e realizuara me mësues, drejtues të shkollave, specialistë të arsimit janë identifikuar problematikat e mëposhtme:

1. *Mungon një politikë vizionarë tërësore për zhvillimin e profesionit të mësuesit.*
2. *Sistemeve të vlerësimit të mësuesve në Shqipëri u mungon bazamenti teorik.* Sistemet e vlerësimit të mësuesve vuajnë të metat që në konceptimin e tyre. Atyre u mungojnë mbështetja në modele teorike, në përvojat më të mira, pikat e referimit, standardet sipas lëndëve dhe kompetencat mbi bazën e të cilave duket të bëhet matja dhe vlerësimi.
3. *Shteti është ende shumë i përfshirë në sistemin e vlerësimit të mësuesve.* Mungojnë organizma të tillë si Urdhëri i Mësuesit apo Shoqatat Profesionale të Mësuesve, të cilat do të merrnin role dhe përgjegjësi që nuk i takojnë shtetit. Decentralizimi i zhvillimit profesional të mësuesve për t'iu përgjigjur më mirë nevojave lokale dhe të shkollave në bazë të planeve të zhvillimit të shkollës do të ishte një veprim i dobishëm.
4. *Sistemi i përgatitjes së mësuesve nuk bazohet në ndonjë dokument kombëtar.* Shumë vende kanë dokumente të tilla dhe përvoja e tyre dëshmon për një sistem të orientuar mirë dhe të efektshëm.
5. *Mungojnë dokumentet e kompetencave dhe standardeve profesionale të mësuesit sipas kategorive të mësuesve.* Janë miratuar vetëm standardet e përgjithshme të mësuesit. Mungesa e tyre krijon një boshllëk referimi dhe e pengon matjen.
6. *Sistemet e vlerësimit të mësuesve janë të paharmonizuara.* Tre sistemet e vlerësimit: për fitimin e të drejtës së ushtrimit të profesionit, për zhvillimin profesional dhe për vlerësimin e performancës veprojnë të shkëputur nga njëri-tjetri, duke vepruar si sisteme më vete.
7. *Cilësia në hyrje e studentëve që përgatiten për mësues ka rreth 20 vjet që është shumë e ulët (nota mestater nga 5-7).* Kjo cilësi në hyrje nuk ndryshon shumë në dalje. Faktorët që kanë ndikuar në këtë tregues janë disa: pas viteve 90-të profesioni i mësuesit nuk gëzon një status të vlerësuar; mungesa e politikave mbështetëse për mësuesit nuk e bën profesionin të pëlqyer; ofrimi i programeve të larmishme të studimit në arsimin e lartë me më shumë përfitime punësimi dhe shpërblimi ka bërë që studentët më të mirë të mos zgjedhin mësuesinë.
8. *Marrëdhënia ndërmjet universitetve dhe shkollave gjatë periudhës së praktikës profesionale nuk është e rregulluar nëpërmjet ndonjë dokumenti rregullator.* Kjo gjë krijon vështirësi në zhvillimin e praktikës dhe cilësinë e saj.

9. *Sistemi i mentorimit për praktikën profesionale është i zbehtë dhe pothuajse nuk funksionon.* Mungesa e ndihmës së mentorëve e kufizon efektshmërinë e praktikës.
10. *Testimi i mësuesve për provimin e shtetit lë për të dëshiruar.* Hartimi i testit nuk ndjek kritere të përcaktuara qartë.
11. *Sistemi më problematik është ai i vlerësimit të performancës së mësuesit që është përgjegjësi e shkollës.*
- *Vlerësime të rralla të performancës.* Mësuesit zakonisht vlerësohen një herë në vit nga drejtuesit e tyre. Shumë mësues, veçanërisht ata më të kualifikuarit, nuk janë vlerësuar për vite më radhë. Këta mësues mund të mos marrin vlerësim për performancën dhe arritjet e tyre për shumë vite.
  - *Vlerësime të sipërfaqshme.* Përgjegjësia më e madhe e një mësuesi është të ndihmojë nxënësit të nxënë. Megjithatë, progresi akademik i nxënësit rrallë mbahet parasysh drejtëpërsëdrejti në vlerësim. Në të kundërt, mësuesit shpesh vlerësohen bazuar në gjykime sipërfaqësore mbi sjelljet dhe praktikat që mund të mos kenë ndikim tek të nxënit e nxënësve.
  - *Vlerësime që mbështeten në burime të pakta,* shpesh vetëm në vrojtimin e një ore mësimi nga drejtori ose nëndrejtori i shkollës. Një burim i vetëm nuk mjafton për të vlerësuar performancën e mësuesit.
  - *Vlerësime të pavlefshme.* Mësuesit e intervistuar, por edhe drejtuesit shprehen se vlerësimet nuk u shërbejnë për të përmirësuar performancën. Mësuesit vërejnë se synimi i drejtuesve është më tepër plotësimi i normës së tyre të kontrollit sesa përdorimi i vlerësimit për të përmirësuar performancën e mësuesit.
  - *Vlerësime të parëndësishme.* Rezultatet e vlerësimeve shumë rrallë përdoren për të marrë vendime të rëndësishme mbi zhvillimin profesional, statusin e mësuesit, promovimin e mësuesit. Në fakt, në shumë prej rasteve të intervistuara, u përmed se performanca e mësuesve konsiderohet vetëm kur është i nevojshëm largimi i tyre nga puna.
  - *Vlerësime të paefektshme.* E ndërsa vlerësimet duhet t'u japin rregullisht mësuesve një informacion për performancën e tyre për t'i ndihmuar që ata të zhvillohen në profesion, ato zhvillohen si një rutinë administrative, por edhe kjo e pambështetur me instrumentet përkatëse.
12. *Mungojnë studimet, vlerësimet kombëtare* mbi bazën e të cilave do të mund të hartoheshin politikat dhe do të merreshin vendime më të mira për mësuesit.
13. *Publikimi i të dhënave dhe rezultateve të vlerësimit të mësuesve është pothuajse inekzistent.* Ka shumë pak informacion dhe ky i dhënë nëpërmjet medias në trajtën e lajmeve për rezultatet e provimit të shtetit dhe të testimit të kualifikimit. Është

shumë e vështirë marrja e informacionit për vlerësimin e mësuesve megjithëse legjislacioni parashikon mënyrën e raportimit të vlerësimeve.

## 6. Praktika dhe modele të mira për zhvillimin profesional dhe vlerësimin e mësuesve në botë

Evidenca nga sisteme të ndryshme arsimit në botë tregon se faktori më i rëndësishëm në përparimin e nxënësve është cilësia e mësuesve dhe e mësimdhënies. Sistemet më të mira të arsimit në botë i përzgjedhin studentët për programet e mësuesisë nga më të mirët, duke dhënë garanci se ata përzgjedhin vetëm ata që kanë një kombinim të mirë të cilësive intelektuale dhe personale. Sistemet më të mira në botë i përgatisin mësuesit në mënyrë të efektshme për t'iu përgjigjur prirjeve të zhvillimit dhe duke u përqendruar në praktikën e klasës. Më pas bëjnë kujdes që mësuesit të përfshihen në programet e zhvillimit profesional gjatë karrierës.

Midis përvojave pozitive të vendeve të ndryshme të botës, studimet dhe vlerësimet ndërkombëtare evidentojnë përvojën e Finlandës, të Singaporit, të SHBA, të Britanisë së Madhe, të Irlandës. Rezultatet e nxënësve të Finlandës dhe Singaporit kanë qenë të shkëlqyera sipas Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve (PISA).

Nga analizat e kryera për Finlandën dhe Singaporin, rezulton se suksesi i nxënësve ka ardhur nga cilësia e lartë e mësuesve.

**Në Finlandë**, cilësia e lartë e mësuesve garantohej nga:

- politika kombëtare mbështetëse për statusin e mësuesit;
- politikë kombëtare për formimin e mësuesve; programet e mësuesisë janë mjaft mirë të strukturuar; ato janë të bazuara në kërkim dhe në praktikë;
- një cilësi e lartë e studentëve që pranohen në programet e mësuesisë. Në vitin 2010 6600 aplikantë konkurruan për 660 vende në 8 universitete për programet e mësuesisë për ciklin e ulët. Ky është një tregues që dëshmon për konkurrencë të lartë dhe për përzgjedhje cilësore.
- Çdo universitet është i lidhur me një shkollë ku mësuesit e ardhshëm kryejnë praktikën dhe profesorët e universitetit zbatojnë risitë.
- Të gjithë mësuesit kërkohet të zotërojnë diplomë master.

**Singapori** ka një model të përgatitjes së mësuesit për shekullin e 21-të që synon transformimin. Ky model përmban 6 rekomandime.

**Rekomandimi i parë** lidhet me vlerat, aftësitë dhe njohuritë. Janë veçuar tri vlera: nxënësi në qendër, identiteti i mësuesit dhe shërbimi ndaj profesionit dhe komunitetit.

**Rekomandimi i dytë** lidhet me kornizën e kompetencave të mësuesit ku theksi vihet në tre dimensione: praktika profesionale, drejtimi e menaxhimi dhe cilësitë personale.

**Rekomandimi i tretë** e vë theksin në lidhjen e teorisë me praktikën që parashikohet të bëhet realitet nëpërmjet procesit të mentorimit, nëpërmjet lidhjes me shkollat ushtrimore, nëpërmjet kërkimit të zbatuar.

**Rekomandimi i katërt** lidhet me repertorin pedagogjik.

**Rekomandimi i pestë** i kushtohet kornizës së vlerësimit për mësimdhënien dhe të nxënit në shekullin e 21-të.

**Rekomandimi i gjashtë** i kushtohet zhvillimit profesional të mësuesve duke kërkuar që të gjithë mësuesit të zotërojnë diplomën master në mësuesi.

Qeveria u jep mësuesve një sërë bonusesh monetare, sociale dhe mjekësore.

Bazuar në përvojën e **SHBA** po paraqesim një sërë parimesh që vlerësohen si praktikë e mirë.

### **Parimet për vlerësimin e mësuesit**

- Një sistem kuptimplotë për vlerësimin e mësuesit duhet të reflektojë një grup besimesh thelbësore rreth mësimdhënies së mirë.
- Vlerësimi vjetor është e vetmja rrugë për të siguruar që të gjithë mësuesit - pavarësisht aftësive të tyre apo viteve të përvojës - marrin vlerësim për performancën e tyre. Të gjitha profesionet kanë nevojë për një vlerësim të tillë. Ky këndvështrim mban parasysh se efektiviteti dhe nevojat zhvillimore të mësuesit mund të ndryshojnë me kalimin e viteve, dhe ky këndvështrim ju përcjell drejtuesve të shkollës mesazhin se ata duhet të jenë përgjegjës për të ndihmuar të gjithë mësuesit e tyre për t'u rritur profesionalisht. Nivelet e vlerësimit për shkollat ju përcjellin atyre informacion të nevojshëm për vendimmarrje që lidhen me punësimin.
- Vlerësimi duhet të karakterizohet nga pritshmëri të qarta dhe rigoroze. Mësuesit duhet të vlerësohen përkundrejt pritshmërive të qarta dhe rigoroze të performancës që mbështet para së gjithash në të dhëna për procesin e të nxënit tek nxënësit. (ndryshe nga fokusimi tek sjelljet e mësuesit apo rutina). Pritshmëritë duhet të reflektojnë ekselencë në klasë, dhe jo minimalisht performancë të pranueshme. Pritshmëritë duhet të jenë hartuar me një gjuhë të qartë dhe të mos lënë hapësirë për interpretim, për t'u siguruar se të gjithë mësuesit dhe instruktorët i interpretojnë ato në të njëjtën mënyrë.
- Drejtoritë arsimore duhet të prodhojnë instrumente të qarta dhe konçize për të ndihmuar drejtuesit e shkollave të vlerësojnë mësuesit vazhdimisht përkundrejt këtyre pritshmërive. Pritshmëritë duhet të rishikohen e pasurohen vazhdimisht, veçanërisht gjatë viteve të para të përdorimit.
- Vlerësimi duhet të bazohet në disa burime dhe matje. Asnjë e dhënë e vetme nuk mund të japë një pamje të plotë të performancës së mësuesit në raport me pritshmëritë. Është kjo arsyeja që sistemi i vlerësimit duhet të përmbajë disa njësi matëse për të përcaktuar nëse mësuesit kanë arritur ose jo pritshmëritë e

performancës së tyre. Kur është e mundur, këto njësi matëse duhet të përmbajnë vlerësime objektive të rritjes akademike të nxënësit, vlerësime në rang rajoni, vëzhgime në klasë etj. Secila prej këtyre njërive duhet të ketë një peshë specifike në mënyrë që mësuesit dhe instruktorët të kuptojnë sesi çdo komponent i vlerësimit ndikon në vlerësimin përfundimtar. Pësha më e madhe duhet të shkojë për vlerësimin e progresit të nxënësve.

- Vlerësimi duhet të përmbajë disa nivele vlerësimi. Çdo mësues duhet të fitojë një nga nivelet e vlerësimit në fund të çdo viti shkollor: psh “shumë i efektshëm”, “i efektshëm”, “ka nevojë për përmirësim”, “i paefektshëm”. Këto kategori vlerësimi u japin mundësi mësuesve të kenë një ide të qarta për performancën e tyre, por nga ana tjetër, janë të pamjaftueshme për të mundësuar një diferencim të qartë, të vazhdueshëm midis niveleve dhe një diferencim që ka kuptim për mësuesit midis tyre si individë, në nivel shkolle, rajoni e më gjerë.
- Vlerësime të herëpashershme dhe të rregullta. Një sistem i mirë vlerësimi nuk duhet të kufizohet dhe të mbetet vetëm tek përcaktimi i një shkalle të vlerësimit që i jepet mësuesit në përfundim të vitit shkollor. Në të kundërt, drejtuesit e institucioneve arsimorë duhet të përpiqen që të kultivojnë një kulturë të fokusuar tek performanca dhe kjo ushqehet nëpërmjet vëzhgimit të vazhdueshëm të mësuesve. Ata duhet të organizojnë rregullisht bashkëbisedime me mësuesit rreth performancës së tyre, progresit të nxënësve, objektivave profesionalë, nevojave zhvillimore si dhe mbështetjes që drejtuesit do të ofrojnë për të mundësuar këto nevoja. Mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve duhet të arrijnë në përfundime të përbashkëta rreth asaj se çfarë duhet të bëjnë mësuesit dhe çfarë duhet të bëjnë drejtuesit për të ndihmuar procesin e përmirësimit. Nëse mësuesit mbeten të habitur me vlerësimin e tyre në fund të vitit, kjo do të thotë se diçka nuk ka funksionuar në procesin e vlerësimit.
- Një proces vlerësimi, për t’u konsideruar dhe mbështetur si nga mësuesit ashtu edhe nga drejtuesit e institucioneve arsimore, duhet të ketë kuptim. Vetëm kështu ai mund të ndikojë në përmirësimin e armatës së mësuesve. Ai duhet të prodhojë informacion që lehtësisht faktorizohet nga drejtuesit rajonalë për vendimmarrje për statusin e mësuesit, pagesat/shpërblimet, zhvillimin, punësimin, promovimin dhe largimin nga puna. Kjo, natyrisht, kërkon që rezultatet të jenë të sakta, të qarta dhe të lehta për t’u interpretuar.

Disa politikëbërës mund të mbështesin përdorimin e rezultateteve të vlerësimit vetëm për të shpërblyer mësuesit shëmbullorë. Por nëse performanca e mësuesit ka rëndësi, ajo ka rëndësi për çdo vendim që ndikon në cilësinë e mësimit që nxënësit marrin. E ndërsa shkollat përpiqen të ndërtojnë skuadra të fuqishme dhe të qëndrueshme mësimdhënëse, arrijtjet e mësuesve në klasë duhet të marrin rëndësi të jashtëzakonshme.

Përgjegjësia për rezultatet e vlerësimit nuk duhet të mbetet vetëm tek mësuesit; aftësia për të identifikuar, zhvilluar dhe mbajtur mësuesit e talentuar, është padiskutim një nga prioritetet më të mëdha të një drejtuesi shkolle. Për këtë arsye, drejtuesit e shkollave duhet të jenë përgjegjës jo vetëm për vlerësimin e saktë të

mësuesve, por edhe për të vepruar mbi bazë të rezultateve dhe për t'i ndihmuar mësuesit të përmirësohen me kalimin e viteve. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për drejtuesit rajonalë e drejtuesit e arsimit në qendër, të cilët duhet të jenë përgjegjës për të siguruar që drejtuesit e shkollave mbikqyren, trajnohen dhe mbështeten për të vlerësuar mësuesit në mënyrë të drejtë, të saktë dhe në vazhdimësi.

Mbështetur në përvojat më të mira, për përmirësimin e sistemit të zhvillimit profesional dhe vlerësimit të mësuesit në Shqipëri, së pari, duhet adoptuar një filozofi, e cila të mbështesë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimin; të motivojë personelin mësimor të hartojë programe individuale për vetëpërmirësim; të lidhë zhvillimin personal me objektivat e zhvillimit të shkollës, të vlerësojë arritjet e mësuesit dhe të përcaktojë objektiva konstruktivë, të krijojë një mjedis pozitiv pune.

Së dyti, duhet hartuar një kornizë filozofike e cila duhet mbështetur në objektivat e përgjithshme të zhvillimit të shkollës; të përmbajë të shprehura qartë objektivat e zhvillimit profesional dhe të vlerësimit të mësuesit; të përfshijë si vlerësimin formues për përmirësim edhe atë përmbledhës për përcaktimin e meritave; të përcaktojë qartë përgjegjësitë e secilës palë që përfshihet në procesin e reformës.

Së treti, duke qenë se sistemi i deritanishëm bazohet në profesionin e rregulluar, duhet ndjekur përvoja e vendeve që e kanë të rregulluar këtë profesion dhe që praktikojnë Urdhërin e mësuesit si ent zbatues.

## 7. Gjetje dhe Rekomandime

### 7.1. Gjetjet e vlerësimit

- Krijimi i një legjislacioni mbështetës për profesionin e mësuesit ka ndihmuar zhvillimin e profesionit të mësuesit. Në dekadën e fundit (2004-2014), Kuvendi i Shqipërisë dhe Qeveria kanë miratuar një sërë ligjesh dhe aktesh nënligjore, që kanë ndikuar në zhvillimin e arsimit në tërësi dhe në profesionin e mësuesit gjithashtu, duke mbështetur ndryshimet në sistemin arsimor dhe përmirësimin e mundësive për nxënësit dhe statusin e mësuesit.
- Përfshirja e profesionit të mësuesit në profesionet e rregulluara është një hap pozitiv që pritet të garantojë një cilësi më të mirë të mësuesve.
- Skema e trajnimeve për mësuesit është tashmë e ndryshuar, duke përcaktuar programet, kriteret, kreditet e kërkuara dhe duke e liberalizuar tregun e trajnimeve.
- Rritja e numrit të mësuesve me arsim të lartë është një prirje pozitive për një cilësi më të lartë të mësuesve.
- Mungojnë kërkimet, vlerësimet apo të dhënat e plota që të mundësojnë një informacion tërësor për ndikimin e legjislacionit dhe të politikave në arsim dhe në statusin e mësuesve.
- Mungon një politikë vizionare tërësore për zhvillimin e profesionit të mësuesit dhe sistemeve të vlerësimit të mësuesve në Shqipëri u mungon bazamenti teorik. Gjithashtu mungojnë studimet, vlerësimet kombëtare mbi bazën e të cilave do të mund të hartoheshin politikat dhe do të merreshin vendime më të mira për mësuesit.
- Shteti është ende shumë i përfshirë në sistemin e vlerësimit të mësuesve. Sistemi më problematik është ai i vlerësimit të performancës së mësuesit që është përgjegjësi e shkollës.
- Politikat e ndërmarra deri më sot nga Ministria e Arsimit, kanë reformuar sistemin e përgatitjes së mësuesve duke ndryshuar strukturën kurrikulare, por nuk u arrit përafrimi i kurrikulave të Institucioneve të Arsimit të Lartë, për shkak të qasjeve të ndryshme që ato kanë përzgjedhur.
- Numri i mësuesve në arsimin parashkollor dhe arsimin e mesëm është rritur, ndërsa numri i mësuesve në arsimin bazë ka pësuar rënie.

- Vërehet se ka një mungesë të balancës gjinore në personelin e punësuar në sistemin arsimor. Shumica e mësuesve në arsimin bazë dhe të mesëm janë femra dhe se asnjë mashkull nuk është i punësuar në arsimin parashkollor.
- Cilësia në hyrje e studentëve që përgatiten për mësues ka rreth 20 vjet që është shumë e ulët, teksa nota mesatare e studentëve në hyrje është nga 5-7, krahasuar me degët e tjera ku kërkohet një mesatare më e lartë për të hyrë në fakultet.
- Marrëdhënia ndërmjet universiteteve dhe shkollave gjatë periudhës së praktikës profesionale nuk është e rregulluar nëpërmjet ndonjë dokumenti rregullator dhe mungon supervizimi i kryerjes së praktikës dhe vlerësimit të saj. Sistemi i mentorimit për praktikën profesionale është i zbehtë dhe pothuajse nuk funksionon.
- Publikimi i të dhënave dhe rezultateve të vlerësimit të mësuesve është pothuajse inekzistent.

## **7.2. Rekomandime**

Ajo që nevojitet më shumë në Shqipëri është një politikë vizionare e artikuluar qartë dhe një bazë institucionale me veprim të efektshëm për të përmirësuar statusin, autoritetin dhe cilësinë e mësuesve. Më poshtë jepen një sërë rekomandimesh për të ndikuar në përmirësimin e cilësisë së mësuesve.

### **Rekomandime për përmirësimin e legjislacionit**

- Nevojitet që të respektohet parimi i konsistencës ndërmjet dokumenteve të ndryshme ligjore në mënyrë që ato të mos bien ndesh me njëri-tjetrin, veçanërisht kur bëhen ndryshime të pjesshme ose sektoriale të legjislacionit. Kjo duhet mbajtur parasysh në ndryshimet ligjore që po ndërmerren aktualisht qeveria shqiptare.
- Është e nevojshme që të përpunohet Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar publik dhe privat duke mbajtur parasysh modele mjaft të mira që përdoren me sukses në disa shtete, në mënyrë që të jetë më i plotë dhe ndihmues.
- Të plotësohet baza ligjore për krijimin e Urdhërit të Mësuesit.

### **Rekomandime për bazën institucionale**

- Të krijohet Urdhëri i Mësuesit i cili të marrë kompetencat që i jep ligji. Ky do të ishte një zhvillim pozitiv në drejtim të ngritjes së institucioneve. Me krijimin e këtij organizmi lind nevoja e rishikimit të roleve dhe përgjegjësisë të organizmave të tjera të përfshira në proces.



- Të krijohet Këshilli Kombëtar për Cilësinë e Mësuesve i cili do të jetë një organizëm i pavarur që do të nxisë reformat për mësuesit, do të hartojë politika për zhvillimin e profesionit të mësuesit, do të këshillojë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për mënyrat sesi të përmirësohet cilësia e mësuesve.
- Të nxitet dhe të mbështetet krijimi i shoqatave të mësuesve që do t'i jeptë një dimension të ri profesionit të mësuesve, do t'i bënte mësuesit më pjesëmarrës dhe të përgjegjshëm për çështjet e arsimit dhe do të ishte një zë i fuqishëm profesional në vendimmarrjen në arsim.

### **Rekomandime për politikën strategjike**

- Është një domosdoshmëri hartimi i strategjisë për zhvillimin e profesionit të mësuesit që të bashkërendojë reformimin e përgatitjes së mësuesve në universitete, zhvillimin e sistemit të përgatitjes praktike të kandidatëve për mësues; konsolidimin e sistemit të zhvillimit profesional dhe zhvillimin e sistemit të vlerësimit të performancës së mësuesve.
- Është domosdoshmëri hartimi i dokumentit strategjik për financimin e personelit arsimor : për pagat, bonuset, praktikën profesionale dhe trajnimet.
- Në kuadrin e reformës kurrikulare të bazuar në kompetenca, nevojitet që të hartohet dhe miratohet dokumenti i kompetencave të mësuesit duke u përqendruar në rolet e mësuesit, duke pasqyruar një vështrim sistematik për profesionalizmin e mësuesit në disa nivele: individual, të shkollës, të komunitetit, rrjeteve profesionale. Ka disa modele të mira për kompetencat : modeli i projektit TUNING, kompetencat e paraqitura nga BE, gjashtë paradigmat e paraqitura nga Paquay & Wagner, 2001.
- Ndonëse herë pas herë është punuar për paketën e standardeve të mësuesve, vetëm paketa për standardet e përgjithshme të mësuesve është miratuar zyrtarisht. Hartimi i një pakete edhe për standardet e mësuesve sipas lëndëve dhe nivele do të ndihmonte procesin e kualifikimit dhe të promovimit të mësuesve. Është një nevojë e ngutshme plotësimi i dokumentacionit të standardeve profesionale të mësuesit të cilat do të përcaktojnë se çfarë duhet të dinë dhe të bëjnë mësuesit.
- Kryerja e vlerësimeve kombëtare për cilësinë e mësuesve çdo 3 vjet do të ishte një praktikë e mirë që do të ndihmonte për marrjen e vendimeve lidhur me cilësinë e mësuesve.

### **Rekomandime për sistemin e përgatitjes së mësuesve**

- Harmonizimi i legjislacionit të arsimit të lartë me politikat për çështje të përgatitjes, të punësimit dhe të vlerësimit të mësuesve.

- Hartimi i një dokumenti kombëtar për formimin e mësuesve ku të paraqiten parimet, modeli i kornizës kurrikulare, kompetencat e mësuesit.
- Ngritja e shkollave ushtrimore/ shkollave të praktikës që do të ndihmonin në një ushtrim praktik cilësor të studentëve dhe do t'i jepnin fund praktikave formale.
- Trajnimi i pedagogëve të programeve të mësuesisë për zbatimin e modelit të formimit të mësuesve, për kurrikulën e bazuar në kompetenca, për partneritetin e ri me shkollat ushtrimore.

### **Rekomandime për sistemin e vlerësimit për fitimin e të drejtës së ushtrimit të profesionit të mësuesit**

- Hartimi i dokumentit të politikës për periudhën e praktikës profesionale.
- Ngritja e sistemit të shkollave ushtrimore.
- Ngritja e sistemit të mentorimit në shërbim të praktikës pedagogjike.

### **Rekomandime për sistemin e vlerësimit të zhvillimit profesional**

- Hartimi i dokumentit të politikës së zhvillimit profesional.
- Hartimi i programeve të trajnimit duke përcaktuar tematikën në bazë të nevojave të diktuar nga reforma dhe në mbështetje të saj.
- Shtimi i krediteve të trajnimit gjatë një viti, nga 1 kredit -25 orë- 3 ditë në 4 kredite-100 orë -12 ditë.
- Përcaktimi i krediteve të kërkuara sipas fushave dhe aspekteve të trajnimit.

### **Rekomandime për sistemin e vlerësimit të performancës**

- Hartimi i dokumentit të politikës për vlerësimin e performancës së mësuesve.
- Hartimi i manualit për vlerësimin e performancës së mësuesve në shkollë.
- Hartimi i instrumenteve për matjen dhe vlerësimin e performancës së mësuesve në shkollë.
- Trajnimi i drejtuesve të shkollave dhe inspektorëve për vlerësimin e performancës së mësuesve në shkollë.

## Referenca

1. A Teacher Education Model for the 21-st Century. A Report by the National Institute of Education, Singapore, 2012.
2. Dispozitat Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar, miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vitin 2013.
3. Inspektimi dhe vlerësimi i brendshëm i shkollës (Udhëzues për inspektimin e plotë të shkollës përgatitur nga IKAP), 2011.
4. Kodi i etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar publik dhe privat (2012).
5. Kontrata Kolektive e Punës e daës 25.05. 2010 për periudhën (2010-2014).
6. Ligji Nr. 69, datë 21.6.2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.
7. Ligji Nr. 7961 of 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 8085 of 13.03.1996, ndryshuar me Ligjin Nr. 9125, datë 29.07.2003.
8. Ligji Nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, ndryshuar me Ligjin nr. 9208, datë 18.03.2004.
9. Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 (i ndryshuar) “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.
10. Ligji Nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” ndryshuar me Ligjin Nr. 10357, datë 16.12.2010.
11. Ligji Nr.10247, datë 04.03.2010 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”.
12. Osmani Shefik. Fjalori i Pedagogjisë, Tiranë, 1983.
13. Programi i Praktikës Profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, miratuar nga MASH, datë 23.01.2011.
14. Raporti Përfundimtar për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Tiranë 2014.
15. Rregullore e MASH Nr. 8937, datë 22.12.2005 “Për shkollat me status “Shkolla të nivelit kombëtar”.
16. Rregullore për sistemin e akreditimit të programeve të trajnimit, miratuar nga MASH më 09.03.2011.
17. Teacher Education and Training in the Western Balkans. Report on Albania. 2013.
18. Standardet e Përgjithshme të Mësuesit, 2013.
19. M. Bruce Haslam, Teacher Professional Development Evaluation Guide , 2010.
20. Udhëzim i MAS Nr.2, datë 05.02.2014 “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.
21. Udhëzim Nr.56, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar”.
22. Udhëzimi MSH Nr.11. datë 17.0.2013 Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë.
23. Udhëzimi Nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e Arsimit Parauniversitar”.
24. Udhëzimi Nr. 37, datë.09.10.2007 i MASH “Për paraqitjen e personelit të shkollës në mjediset shkollore” përmban rregulla për mënyrën sesi duhet të paraqitet mësuesi në shkollë.

25. Udhëzimi Nr. 49, datë 27.12.2006 i MASH "Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve" udhëzon mësuesit sesi duhet të hartojnë objektivat e arritjeve sipas niveleve të nxënësve.
26. Udhëzimi Nr.38, datë 09.10.2007 i MASH "Për zhvillimin e orëve të lira në shkollë" përcakton rregulla për zhvillimin e orëve të lira në shkollë.
27. UNESCO Recommendation Concerning the Status of Teachers, adopted by the Special Intergovernmental Conference on the Status of Teachers, Paris, 5 October 1966.
28. UNESCO Strategy on Teachers (2012-2015).
29. Urdhër i MASH Nr.82, datë 22.2.2011 për miratimin e Rregullores për organizimin e provimeve të shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë".
30. Urdhër i MASH Nr.82, datë 22.2.2011 për miratimin e Rregullores për organizimin e provimeve të shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë".
31. Urdhëri i MASH Nr.336, datë 14.07.2011 "Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit".
32. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", i ndryshuar.
33. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 952, datë 12.12.2012 Për përshtimin e profesionistit nga detyrimi për dhënien e provimit të shtetit për profesionet e rregulluara.
34. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 194, datë 22.04.1999 "Për miratimin e strukturës së pagave të personelit mësimor në arsimin parauniversitar".
35. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 537, datë 26.09.1994 "Për shtesë mbi pagën bazë për kualifikim të mësuesve dhe shtesë për veprimtari të inspektorëve të arsimit".
36. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 66, datë 03.02.2010 "Për riorganizimin e drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore".
37. Vjetari Statistikor për Arsimin 2011-2012 dhe seri kohore.